MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data: 28.10.26 Nr. 01-3015

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 01/3
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot.No.: 2263
Nr. i fajlove / Broj stranica / No. pages: 1
Data: / Datum: / Date: 18.11.26
PRISHTINË/A NO.1

Plani i Biznesit 2027- 2029 i KRUM-së

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt nr. 09-2026 të mbajtur më datë 28.10.2026 pas shqyrtimit të Planit të Biznesit 2027-2029 aprovoi Planin e Biznesit. Plani i aprovuar do t'i dërgohet NJPMNP-së.

	Delegoi	*Aprovoi*
Emri Mbiemri	*Kryeshefi Ekzekutiv: Bashkim Kurti*	*Kryesuese e BtD-së: Kurmrije Kelmendi Aliu*
Nënshkrimi		
Data	*28.10.2026*	*28.10.2026*

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" Sh. A.

PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2027

PARASHIKIMI PËR VITET 2028-2029

Mitrovicë, Tetor 2026

PËRMBAJTJA

.....2

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....5

2. PREZANTIMI I ORGANIZATËS.....6

3. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE.....7

3.1. Analiza organizative.....7

3.2. Analiza teknike dhe operative.....16

3.3. Analiza financiare.....22

3.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet).....23

4. VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....25

4.1. Vizioni.....25

4.2. Misioni.....25

4.3. Vlerat Themelore.....25

Objektivat Strategjikë.....25

5. STRATEGJITË KRYESORE ZHVILLIMORE.....26

5.1. Strategjia Financiare.....26

5.2. Strategjia Teknike dhe Operative.....26

5.3. Strategjia për Konsumatorët.....27

5.4. Strategjia për Burimet Njerëzore.....28

5.5. Strategjia për Inovacion dhe Digjitalizim.....31

5.6 Strategjia e integrimit të komunave veriore.....32

6. PLANI OPERACIONAL / ZHVILLIMOR.....35

7. PLANI FINANCIAR.....38

7.1. Të ardhurat dhe shpenzimet operative.....39

7.2. Analiza financiare e shitjes.....42

7.3. Burimet e financimit.....47

8. PLANI I INVESTIMEVE.....47

8.1. Projektet kryesore kapitale.....47

8.2. Analiza e fizibilitetit dhe ndikimit.....57

8.3. Afatet dhe prioritetet kohore 58
9. RREZIQET DHE MENAXHIMI I TYRE 60
10. PJESA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE 62
11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI 64
11.1. Mekanizmat e monitorimit 64
11.2. Indikatorët e performancës 64
12. MJEDISI, KOMUNITETI DHE TRANSPARENCA 65
SHTOJCË 66

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Biznesit i KRU "Mitrovica" Sh.A. për periudhën 2027–2029 përcakton orientimin strategjik, financiar dhe operacional të ndërmarrjes, me synim forcimin e qëndrueshmërisë financiare, përmirësimin e efikasitetit teknik, konsolidimin e operimit në të gjithë zonën e shërbimit dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve. Një fokus i veçantë gjatë kësaj periudhe do të jetë funksionalizimi i plotë i njësive veriore dhe përfshirja progresive e konsumatorëve të tyre në sistemin e rregullt të faturimit dhe arkëtimit.

Gjatë periudhës së planifikimit, numri i konsumatorëve të regjistruar parashihet të rritet nga 76,374 në vitin 2027 në 77,909 në vitin 2029, ndërsa uji i faturuar nga 10.11 milionë m^3 në 10.73 milionë m^3. Prodhimi i ujit planifikohet të mbahet në nivel prej rreth 29.5–30 milionë m^3 në vit, duke synuar që rritja e faturimit të realizohet përmes shfrytëzimit më efikas të ujit të prodhuar dhe reduktimit gradual të humbjeve. Uji i pafaturuar parashihet të ulet nga 66.3% në vitin 2027 në 63.6% në vitin 2029, megjithëse niveli i tij vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore teknike dhe financiare të ndërmarrjes.

Në aspektin financiar, faturimi me tvsh planifikohet të rritet nga 7.97 milionë euro në vitin 2027 në 8.45 milionë euro në vitin 2029, ndërsa arkëtimet nga 8.29 milionë euro në 8.79 milionë euro. Shkalla e arkëtimit prej 104% reflekton synimin që, krahas faturave rrjedhëse, të arkëtohet edhe një pjesë e borxheve të akumuluara. Shpenzimet operative pa amortizim parashihet të rriten nga 7.85 milionë euro në 8.16 milionë euro, ndërsa norma e mbulesës së punës përmirësohet gradualisht nga 1.03 në 1.05, duke ruajtur aftësinë e ndërmarrjes për mbulimin e shpenzimeve operative nga të hyrat e veta.

Numri i punëtorëve planifikohet të rritet në 380 në vitin 2027 dhe të mbetet në të njëjtin numër përgjatë periudhës 2027–2029, kryesisht si rezultat i zgjerimit të zonës së operimit dhe funksionalizimit të njësive veriore. Për këtë arsye, kontrolli i kostove të personelit, rritja e produktivitetit dhe organizimi efikas i proceseve të punës do të jenë me rëndësi të veçantë. Paralelisht, ndërmarrja do të vazhdojë me përmirësimin e menaxhimit financiar, adresimin e rekomandimeve të auditimit, avancimin e sistemeve të raportimit dhe forcimin e kontrollit të brendshëm.

Në aspektin teknik dhe investiv, prioritet mbetet rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit, reduktimi i humbjeve, përmirësimi i sistemeve të matjes dhe monitorimit, modernizimi i pajisjeve dhe investimet që ndikojnë në rritjen e efikasitetit operacional dhe energjetik. Për vitin 2027 janë planifikuar 238,245 euro investime me mjete vetanake, krahas investimeve dhe projekteve të financuara nga institucionet vendore dhe partnerët zhvillimorë.

Në tërësi, Plani i Biznesit 2027–2029 synon konsolidimin e KRU "Mitrovica" Sh.A. si një ndërmarrje financiarisht e qëndrueshme dhe operacionalisht efikase. Rritja e faturimit dhe arkëtimit, integrimi i njësive veriore, zgjerimi i bazës së konsumatorëve dhe ruajtja e mbulimit pozitiv operacional përbëjnë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë, ndërsa reduktimi i ujit të pafaturuar, kontrolli i shpenzimeve dhe rritja e efikasitetit të stafit mbeten ndër prioritetet kryesore për periudhën 2027–2029.

2. PREZANTIMI I ORGANIZATËS

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” Sh.A. është ndërmarrje publike rajonale me aksionar Qeverinë e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë, e cila ofron shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm dhe menaxhimit të ujërave të ndotura. Kompania ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat rregullatore të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, ku këtë vit është rilicencuar si ofruesi i vetëm i shërbimeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit në rajonin e mitrovicës duke përfshi shtatë Komunat, Mitrovicë Jugore, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Zvecan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Ujësjellësi i Mitrovicës ka një histori që daton nga vitet 1940, ndërsa sot KRU “Mitrovica” operon me katër Impiante të Trajtimit të Ujit – Shipol, Balincë, Zubin Potok dhe Leposaviq si dhe me Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Llaushë. Kompania menaxhon një rrjet të gjerë të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ofron shërbime në territorin e shtatë komunave: Mitrovicë Jugore, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Që nga viti 2025, KRU “Mitrovica” ka zgjeruar veprimtarinë e saj në komunat veriore, duke organizuar operimin përmes njësive Mitrovicë e Veriut/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Integrimi i këtyre njësive po zhvillohet në mënyrë graduale dhe procesi po shënon progres të vazhdueshëm në identifikimin dhe regjistrimin e konsumatorëve, lidhjen e kontratave të shërbimit, vendosjen e ujëmatësve dhe përfshirjen progresive të konsumatorëve në sistemin e faturimit dhe arkëtimit. Plani operacional parasheh pikërisht kalimin gradual nga regjistrimi dhe matja drejt faturimit dhe inkasimit të rregullt. Sipas gjendjes së raportuar më 2 tetor 2026, nga një bazë e parashikuar prej rreth 17,000 konsumatorësh në njësitë veriore, janë identifikuar 8,366 konsumatorë, janë regjistruar 6,848, janë raportuar 6,761 kontrata shërbimi dhe janë vendosur 1,994 ujëmatës. Bashkëpunimi ndërmjet njësive, stafit lokal dhe ekipeve të angazhuara vlerësohet përgjithësisht i kënaqshëm dhe procesi po konsolidohet në vazhdimësi. Procesi i regjistrimit do të vazhdojë sipas zonave prioritare dhe përmes ekipeve në terren, me qëllim të zgjerimit gradual të bazës së konsumatorëve të gatshëm për faturim. Në aspektin institucional dhe organizativ, zgjerimi i zonës së operimit ka kërkuar rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të ndërmarrjes. Vetëm në njësitë veriore gjatë vitit 2026 janë punësuar 115 punonjës në pjesën veriore, prej të cilëve 105 janë aktualisht në punë në shtator 2026, ndërsa janë përforcuar funksionet komerciale, faturimi, leximi, kontrolli dhe arkëtimi për të mbështetur procesin e regjistrimit dhe kalimin në faturim të rregullt.

KRU “Mitrovica” bashkëpunon gjithashtu me institucione vendore dhe partnerë ndërkombëtarë në realizimin e projekteve kapitale dhe zhvillimore, me fokus në rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës, reduktimin e humbjeve të ujit, trajtimin e ujërave të ndotura, digjitalizimin dhe përmirësimin e efikasitetit operacional. Zhvillimet e viteve të fundit, veçanërisht zgjerimi i zonës së shërbimit dhe konsolidimi gradual i njësive veriore, kanë rritur ndjeshëm shtrirjen dhe përgjegjësinë operative të ndërmarrjes. Kompania është partnere e rëndësishme në projekte zhvillimore me KFW, BERZH dhe Bashkimin Evropian, të cilat mbështesin investimet kapitale për rehabilitimin e rrjetit, ndërtimin e impianteve të reja dhe digjitalizimin e proceseve. Falë këtij zhvillimi institucional dhe

teknologjik, KRU “Mitrovica” është pozicionuar si një ndërmarrje publike moderne dhe e qëndrueshme, që udhëheq me transparencë, efikasitet dhe përkushtim ndaj qytetarëve të rajonit.

3. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

3.1. Analiza organizative

KRU “Mitrovica” Sh.A. funksionon në bazë të strukturës së përcaktuar me Statutin dhe aktet e brendshme të Kompanisë, duke siguruar ndarjen e qartë të përgjegjësive ndërmjet organeve drejtuese, menaxhmentit të lartë dhe njësive organizative.

KRU "Mitrovica" Sh.A. është një kompani publike nën administrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila njëkohësisht është edhe aksionare e Ndërmarrjes.

Bordi i Drejtorëve, si organi më i lartë drejtues i ndërmarrjes, mbikëqyr Menaxhmentin Ekzekutiv, i cili udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Në realizimin e objektivave strategjike dhe operative të Kompanisë, Kryeshefi Ekzekutiv mbështetet nga drejtorët e departamenteve dhe strukturat e tjera organizative të ndërmarrjes.

Struktura organizative e KRU “Mitrovica” Sh.A. përbëhet nga katër (4) departamente kryesore:

- Departamenti Administrativ;
- Departamenti Financiar;
- Departamenti Komercial; dhe
- Departamenti Teknik.

Departamentet dhe njësitë organizative në kuadër të tyre funksionojnë në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me strukturën organizative dhe aktet e brendshme të Kompanisë, me qëllim të sigurimit të koordinimit ndërmjet funksioneve administrative, financiare, komerciale dhe teknike, si dhe ofrimit efikas dhe të qëndrueshëm të shërbimeve.



Figura 1. Struktura Organizative

Figura 1. Struktura Organizative - paraqet strukturën organizative të KRU "Mitrovica" Sh.A., duke pasqyruar në mënyrë grafike nivelet e qeverisjes, menaxhimit dhe organizimit funksional të Kompanisë, si dhe raportet hierarkike ndërmjet tyre.

Struktura organizative është e ndërtuar sipas modelit hierarkik, ku kompetencat, përgjegjësitë dhe autorizimet përcillen nga nivelet më të larta drejtuese drejt departamenteve, njësive dhe niveleve përkatëse operative. Në drejtim të kundërt realizohet raportimi, komunikimi dhe llogaridhënia për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive, nga nivelet operative drejt niveleve menaxhuese dhe drejtuese.

Kjo strukturë synon të sigurojë ndarje të qartë të përgjegjësive, linja të përcaktuara të raportimit, koordinim ndërmjet njësive organizative dhe funksionim efikas të proceseve të punës në kuadër të Kompanisë.

Nivelet e drejtimit dhe njësitë operative

Organizimi i brendshëm i Kompanisë mbështetet në katër nivele drejtimi, ku në nivelin e parë qëndron Kryeshefi Ekzekutiv, në nivelin e dytë drejtorët e departamenteve, në nivelin e tretë menaxherët e divizioneve, ndërsa në nivelin e katërt shefat e seksioneve, me ç'rast secili nivel ushtron kompetencat e veta brenda autorizimeve të përcaktuara me aktet e brendshme. Krahas departamenteve qendrore, veprimtaria në terren organizohet përmes gjashtë njësive operative, përkatësisht Mitrovicë,

Skenderaj, Vushtrri, Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, të cilat sigurojnë operimin e përditshëm dhe te mirëfillët.

Me rishikimin e skemës organizative në vitin 2025, njësitë operative veriore janë përfshirë formalisht në strukturën e Kompanisë, ndërsa secila prej tyre është organizuar me menaxhim operativ, staf teknik dhe të mirëmbajtjes, staf komercial për lexim, kontroll dhe arkëtim, si dhe me shërbime të përbashkëta mbështetëse. Duke marrë parasysh se integrimi formal ka përparuar më shpejt se integrimi funksional, prioritet i periudhës 2027–2029 mbetet përcaktimi i qartë i linjave të raportimit ndërmjet njësive operative dhe departamenteve qendrore, delegimi i autorizimeve në nivel njësie dhe zbatimi i procedurave të njëjta standarde në të gjitha njësitë, me qëllim që struktura e miratuar të shndërrohet në praktikë të përditshme menaxhuese.

Shpërndarja e punonjësve sipas njësive operative, sipas evidencës së personelit me gjendje më 30 shtator 2026, paraqitet në tabelën në vijim, ku njësia e Mitrovicës përfshin edhe stafin e selisë qendrore të Kompanisë.

Punonjësit sipas njësive operative (30 shtator 2026)

Njësia operative	Punonjës	Pjesëmarrja	Meshkuj	Femra	Mosha mesatare
Mitrovicë	149	42.7%	125	24	48.2
Vushtrri	63	18.1%	58	5	47.5
Skenderaj	32	9.2%	30	2	50.8
Mitrovicë e Veriut / Zveçan	42	12.0%	36	6	42.7
Zubin Potok	33	9.5%	26	7	40.9
Leposaviq	30	8.6%	27	3	46.9
Gjithsej	349	100%	302	47	46.8

Viti 2026: zgjerimi organizativ dhe zhvillimet kryesore

Gjatë vitit 2026, me zgjerimin e shtrirjes operative në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, KRU “Mitrovica” Sh.A. ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit organizativ dhe operacional. Për njësitë operative në veri janë miratuar fillimisht 19 pozita, që përfshijnë gjithsej 119 vende pune. Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar për 116 vende pune, pasi që për tri vende pune procedurat përkatëse ishin përfunduar në fund të vitit 2025.

Procesi i rekrutimit është zhvilluar në kuadër të një procesi të mbështetur dhe monitoruar nga partnerë dhe institucione ndërkombëtare, përfshirë Bashkimin Evropian, GIZ Gjerman dhe RPHS LAW, duke synuar rritjen e transparencës dhe respektimin e procedurave përkatëse të rekrutimit.

Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me rregulloret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve, përkatësisht Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit dhe Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës, të cilat janë rishikuar gjatë vitit 2025, me ç'rast pozitat e reja janë përcaktuar sipas strukturës organizative dhe rregulloren e sistematizimit të rishikuar, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve është realizuar në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren për procedurat e rekrutiit, duke siguruar kështu bazë të qartë ligjore dhe transparencë në çdo fazë të procesit, si rezultat i këtij procesi, numri i punonjësve arrin në 349 punonjës më 30 shtator 2026.

Gjatë vitit 2026, në njësitë veriore janë përzgjedhur gjithsej 115 punonjës, ndërsa në muajin shtator numri i punonjësve aktivë ka qenë 105, gjatë kësaj periudhe, një punonjës ka dhënë dorëheqje. Nga numri i përgjithshëm i punonjësve aktivë, 42 janë të angazhuar në njësinë e Mitrovicës së Veriut/Zveçanit, 33 në njësinë e Zubin Potokut dhe 30 në njësinë e Leposaviqit. Plotësimi i pozitave të mbetura do të bëhet në mënyrë graduale, në përputhje me dinamikën e regjistrimit të konsumatorëve dhe nevojat operative të verifikuara të njësive përkatëse.

Struktura e njësive përfshin pozita që lidhen me menaxhimin, mirëmbajtjen e rrjetit, operimin teknik, leximin e ujëmatësve, faturimin, arkëtimin, administratën dhe shërbimet mbështetëse, në përputhje me nevojat specifike të secilës zonë operative.

Të arriturat kryesore në vitin 2026

Në fushën e burimeve njerëzore dhe të administratës, rezultatet kryesore të vitit 2026 janë:

- Funksionalizimi i tri njësive operative veriore përmes punësimit të 115 punonjësve, në një proces rekrutimi të monitoruar nga Bashkimi Evropian, GIZ dhe RPHS LAW L.L.C (Kompania Konsulente për shërbime juridike) e cili ka siguruar transparencë dhe përfshirje të komuniteteve lokale;

- Përfshirja e stafit të njësive veriore në sistemin e pagave të Kompanisë,

- Konsolidimi i evidencës së personelit, me të dhëna për moshën, shkollimin, gjininë, stazhin dhe vitin e pensionimit për secilin punonjës, e cila shërben si bazë për planifikimin e zëvendësimeve dhe të nevojave për staf,

- Hartimi i Planit të Trajnimeve dhe Zhvillimit Profesional 2027–2029, në bazë të nevojave të paraqitura nga departamentet dhe njësitë organizative;

- Pjesëmarrja në vlerësimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve, të realizuar me mbështetjen e GIZ, si dhe në fazën fillestare të Programit për Përmirësimin e Performancës Financiare dhe Operative (FOPIP), i cili përfshin edhe zhvillimin institucional dhe të burimeve njerëzore;

- Identifikimi i nevojave për punonjës për periudhën 2027–2029, të cilat përfshijnë nevojat e reja operative dhe zëvendësimin e pozitave që lirohen nga pensionimet.

- Kontrolla sistematike si dhe sigurimi shendetësor 100% i punonjesve të KRUM-së.

- Kurset e gjuhes Shqip-Serbisht-Shqip për stafin e kompanise, në koordinim me Europe House ne Mitrovicë

Sfidat e identifikuara gjatë vitit 2026

Krahas rezultateve të arritura, viti 2026 ka nxjerrë në pah disa sfida që kërkojnë adresim të planifikuar gjatë periudhës 2027–2029. Sfida e parë lidhet me strukturën e moshës, ngase 162 punonjës, përkatësisht 46.4% e stafit, janë 50 vjeç e më shumë.

Sfida e dytë lidhet me harmonizimin e procedurave dhe praktikave të punës ndërmjet njësive operative të jugut dhe atyre të veriut, duke qenë se procedurat standarde zbatohen kryesisht në njësitë e jugut, ndërsa stafi i ri në veri ka nevojë për orientim dhe trajnime shtesë lidhur me sistemet, procedurat dhe mënyrën e funksionimit të Kompanisë.

Një sfidë tjetër ka të bëjë me verifikimin dhe nostrifikimin e diplomave të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, proces i cili paraqet një kërkesë shtesë administrative në menaxhimin dhe sistemimin e burimeve njerëzore.

Për më tepër, raporti ndërmjet numrit të punonjësve dhe numrit të konsumatorëve në njësitë veriore mbetet i lartë deri në përfundimin e procesit të regjistrimit të konsumatorëve. Kjo e bën të domosdoshme që çdo rekrutim i mëtejshëm të bazohet në nevojat reale operative dhe në ngarkesën e punës, duke marrë parasysh progresin dhe rezultatet në regjistrimin e konsumatorëve, faturimin dhe arkëtimin.

Së fundi, pjesëmarrja e ulët e grave, e cila arrin 13.5% (47 nga 349 punonjës), varësia e disa funksioneve nga një numër i vogël punonjësish, si në GIS dhe në marrëdhëniet me publikun, si dhe profili i shkollimit, ku 85.7% e punonjësve kanë shkollim të mesëm, e bëjnë të nevojshëm forcimin e planifikimit të zëvendësimeve dhe të programeve të zhvillimit profesional.

Profili i personelit dhe interpretimi i të dhënave

Analiza e profilit të personelit bazohet në evidencën e personelit me gjendje më 30 shtator 2026, e cila përfshin 349 punonjës, prej të cilëve 347 aktivë dhe 2 pasivë, ndërsa mosha e pensionimit është llogaritur 65 vjeç.

Struktura e moshës

Grupmosha	Punonjës	Pjesëmarrja
Nën 30 vjeç	28	**8.0%**
30–39 vjeç	66	**18.9%**
40–49 vjeç	93	**26.6%**
50–59 vjeç	116	**33.2%**

60 vjeç e më shumë	46	13.2%
Gjithsej	349	100%

Mosha mesatare e punonjësve është 46.8 vjeç, ndërsa punësimet e vitit 2026, kryesisht në njësitë veriore, e kanë ulur moshën mesatare të Kompanisë.

Gjatë periudhës 2027–2029 pritet të pensionohen 21 punonjës, që përbëjnë 6.0% të stafit aktual, ku në vitin 2027 pensionohen 2 punonjës, në vitin 2028 pensionohen 10 punonjës, ndërsa në vitin 2029 pensionohen 9 punonjës, ku nga 21 punonjës 13 prej tyre janë në njësinë e Mitrovicës, ku janë të përqendruara edhe funksionet qendrore dhe pozitat me përvojë të gjatë teknike. Kjo e bën të domosdoshme identifikimin me kohë të plotësimit të pozitave të punës që do të lirohen si rezultat i pensionimeve, duke marrë parasysh nevojat reale operacionale dhe organizative. Gjithashtu, duhet të sigurohet bartja e përvojës dhe njohurive profesionale nga punonjësit që pensionohen te punonjësit që do të angazhohen në ato pozita, përmes orientimit dhe trajnimit paraprak, me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë dhe efikasitetit në kryerjen e proceseve të punës.

Burimet njerëzore në njësitë veriore: gjendja dhe analiza

Me qëllim të integrimit të plotë funksional të stafit verior, gjatë vitit 2027 do të zbatohen këto masa:

- Program i strukturuar i orientimit për stafin e ri, që përfshin aktet e brendshme, kodin e etikës, sigurinë dhe shëndetin në punë, procedurat e reagimit emergjent dhe shërbimin ndaj konsumatorëve,

- Harmonizimi i procedurave standarde të punës për operim, mirëmbajtje, lexim, faturim, arkëtim dhe trajtim të ankesave, të hartuara në gjuhën shqipe dhe serbe,

- Mentorimi dhe puna e përbashkët e ekipeve nga njësitë e jugut me stafin verior në fushat teknike dhe komerciale,

- Rishikimi i produktivitetit dhe i strukturës së stafit në fund të vitit 2027, kur do të jenë në dispozicion të dhëna të besueshme për konsumatorët dhe ngarkesën e punës;

- Plani për ngritjen e kapaciteteve që do të realizohet nga kompania konsulente në kuadër të FOPIP-it.

Planifikimi i Stafit

Planifikimi i stafit për periudhën 2027–2029 është hartuar në bazë të evidencës së personelit me gjendje më 30 shtator 2026, të pensionimeve të pritshme sipas moshës së pensionimit prej 65 vjeç, të pozitave që kanë mbetur të lira nga konkurset për njësitë operative veriore dhe të nevojave të

identifikuara nga departamentet dhe njësitë organizative, me qëllim që numri i punësimeve për secilin vit të jetë i arsyetuar dhe në përputhje me numrin e punëtorëve në planin financiar.

Nevojat për punësime për periudhën 2027–2029

Nevoja 2027	Nevoja 2028	Nevoja 2029
35	10	9

Pozitat e planifikuara për rekrutim përfshijnë nevoja të reja operative, zëvendësimin e pozitave të liruara si rezultat i pensionimeve dhe largimeve të tjera.

Arsyetimi i punësimeve për vitin 2027

Nga gjithsej 35 punësimet e planifikuara për vitin 2027, 2 punësime lidhen me zëvendësimin e punonjësve që pensionohen gjatë vitit, ndërsa 15 punësime kanë të bëjnë me plotësimin e pozitave që kanë mbetur të lira nga konkurset e parapara për njësitë operative veriore, ngase një pjesë e kandidatëve të përzgjedhur nuk e kanë përfunduar procesin e verifikimit dhe/ose nostrifikimit të diplomave, një pjesë kanë dhënë dorëheqje, ndërsa të tjerët nuk e kanë nënshkruar kontratën e punës ose nuk janë paraqitur në punë. Rrjedhimisht, këto pozita janë pjesë e strukturës organizative dhe e sistematizimit të miratuar për njësitë veriore, andaj plotësimi i tyre nuk paraqet zgjerim të strukturës, por kompletim të saj.

Krahas kësaj, 8 punësime kanë të bëjnë me zëvendësimin e pozitave të lira jashtë njësive veriore, përkatësisht të pozitave të menaxherit për konsumatorë, inxhinierit hidroteknik, menaxherit të planifikimit dhe zhvillimit, inxhinierit të procesit, operatorit teknik në ITUZ, dy lexuesve të ujëmatësve dhe zyrtarit për ankesa, kërkesa dhe menaxhimin e ujëmatësve, ndërsa 10 punësimet e mbetura paraqesin shtim të stafit të ri, me ç'rast struktura dhe arsyetimi i secilës kategori paraqiten në tabelën në vijim.

Struktura e punësimeve të planifikuara për vitin 2027

Nr.	Kategoria / pozita	Nr.	Arsyetimi	Pozitat
A	**Zëvendësimi i pensionimeve**	2	Plotësimi i pozitave që lirohen nga pensionimi i punonjësve gjatë vitit 2027, sipas evidencës së personelit, me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së funksioneve dhe të transferimit të njohurive.	**Rojtar**

B	Pozitat e mbetura të lira nga konkurset e parapara për njësitë operative veriore	15	Pozita të parapara me konkurset për njësitë veriore, të cilat kanë mbetur të paplotësuara si rezultat i mospërfundimit të procesit të verifikimit dhe/ose nostrifikimit të diplomave, dorëheqjeve, mosnënshkrimit të kontratës së punës, mosparaqitjes në punë, mungesës së kandidatëve dhe pensionimit, sipas Tabelës 3.	Shef i mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe të kanalizimit – 1, Shef i leximit dhe i faturimit – 1, Ujëinstalues – 2, Kanalizator 1, Pastruese – 1, Rojtar – 1, Inxhinier përgjegjës i hidroteknikës – 1, Kontrollues – 1, Lexues – 5, Arkëtar – 1.
C	Zëvendësimi i pozitave të lira jashtë njësive veriore	11	Pozita të lira në strukturën ekzistuese, plotësimi i të cilave është i domosdoshëm për vazhdimësinë e funksioneve teknike, komerciale dhe të planifikimit.	Menaxher për konsumatorë – 1, Inxhinier hidroteknik – 1, Inxhnier i Elektros-1 Menaxher i planifikimit dhe zhvillimit – 1, Inxhinier procesi – 2, Operator teknik në ITUZ Llaushe– 2, Lexues – 2(Skenderaj-Vushtrri) Zyrtar për ankesa, kërkesa dhe menaxhimin e ujëmatësve – 1,
D	Shtimi i stafit të ri	7	Pozita të reja në strukturën organizative, të nevojshme për përballimin e zgjerimit të zonës së shërbimit dhe të numrit të punonjësve.	Mirëmbajtës i objekteve-1 Koordinator për burime njerëzore-1 Zyrtar per Raportim dhe Komunikim(veri)-1 Shef kontrolle Mitrovice-Vushtrri 2, Kontrolle Skënderaj-2,
	Gjithsej	35		

Pozitat e mbetura të lira nga konkurset për njësitë operative veriore

Për njësitë operative veriore, procedurat e rekrutimit janë zhvilluar për 116 vende pune, me ç'rast janë përzgjedhur 115 kandidatë dhe janë nënshkruar 109 kontrata pune, ndërsa për pozitën e inxhinierit të hidroteknikës, nga dy vende pune të parapara, është plotësuar vetëm njëri, ngase në konkurs nuk ka

pasur kandidatë të tjerë. Si rezultat i këtij procesi, 15 pozita kanë mbetur të paplotësuara, të cilat paraqiten sipas pozitave dhe arsyeve në tabelën në vijim.

Pozitat e mbetura të lira në njësitë operative veriore sipas arsyeve

Nr.	Pozita	Vende pune të parapara	Pozita të lira	Arsyeja
1	Shef i mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe të kanalizimit	3	1	Kandidati i përzgjedhur nuk e ka filluar punën
2	Shef i leximit dhe i faturimit	3	1	Mospërfundimi i procesit të verifikimit të diplomës
3	Ujëinstalues	10	2	Një dorëheqje dhe një mospërfundim i procesit të verifikimit/ nostrifikimit të diplomës
4	Kanalizues	10	1	Mosnënshkrimi i kontratës së punës
5	Pastruese	4	1	Dorëheqje
6	Inxhinier përgjegjës i hidroteknikës	2	1	Mungesa e kandidatëve të mjaftueshëm në konkurs
7	Rojtar	16	1	Pension
8	Lexues	17	5	Dy dorëheqje, një mospërfundim i procesit të verifikimit të diplomës dhe dy mosparaqitje në punë
9	Kontrollues	3	1	Mospërfundimi i procesit të verifikimit/nostrifikimit të diplomës
10	Arkëtar	8	1	Mosparaqitja për nënshkrimin e kontratës së punës
	Gjithsej	76	15	

Nga tabela rezulton se, nga 15 pozitat e mbetura të lira, 4 pozita lidhen me mospërfundimin e procesit të verifikimit dhe/ose nostrifikimit të diplomave, 4 pozita me dorëheqjet e kandidatëve të punësuar, 3 pozita me mosparaqitjen në punë ose mosfillimin e punës, 2 pozita me mosnënshkrimin e kontratës së punës, ndërsa nga një pozitë lidhet me mungesën e kandidatëve në konkurs, përkatësisht me pensionimin.

Arsyetimi i punësimeve për vitet 2028 dhe 2029

Për vitet 2028 dhe 2029 janë planifikuar 10, përkatësisht 9 punësime, të cilat kufizohen vetëm në zëvendësimin e punonjësve që pensionohen sipas evidencës së personelit, ngase numri i punonjësve mbahet në nivelin prej 380, ndërsa çdo nevojë e re operative, përfshirë stafin për operimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, do të plotësohet brenda këtij numri dhe vetëm pas vlerësimit të nevojës.

Për më tepër, kulmi i pensionimeve në vitin 2028 dhe përqendrimi i 13 nga 21 pensionimet e periudhës në njësinë e Mitrovicës, ku janë të vendosura funksionet qendrore dhe pozitat me përvojë të gjatë teknike, e bëjnë të domosdoshëm identifikimin me kohë të pasardhësve dhe transferimin e njohurive përmes mentorimit dhe punës së përbashkët para pensionimit.

Politikat e brendshme dhe rregulloret

Funksionimi i Burimeve Njerëzore dhe i Administratës në KRU "Mitrovica" Sh.A. bazohet në Statutin e Kompanisë, skemën organizative dhe aktet e brendshme që rregullojnë sistematizimin e vendeve të punës, rekrutimin, marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë periudhës 2027–2029, planifikohet rishikimi dhe harmonizimi i akteve ekzistuese, si dhe hartimi i akteve të reja, në përputhje me nevojat e Kompanisë dhe legjislacionin në fuqi.

Përgjegjës për hartimin dhe koordinimin e këtij procesi do të jenë Departamentet përkatëse të Kompanisë dhe me mbështetjen e asistencës teknike të FOPIP-it. Aktet e përgatitura do t'u nënshtrohen procedurave përkatëse të shqyrtimit dhe miratimit nga organet kompetente, në përputhje me Statutin e Kompanisë dhe legjislacionin në fuqi. Pas miratimit, ato do të vihen në dispozicion të të gjithë punonjësve, me qëllim të sigurimit të informimit të barabartë dhe zbatimit të njëtrajtshëm të rregullave të brendshme.

3.2. Analiza teknike dhe operative

KRU "Mitrovica" menaxhon një sistem të integruar të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimit, me infrastrukturë të shpërndarë në shtatë komuna. Sistemi përfshin tri fabrika funksionale të trajtimit të ujit, një fabrikë në Leposaviq që ende nuk është përfunduar plotësisht, si dhe dy pika të tjera të trajtimit të ujit, një në Leshak dhe tjetrën në Soçanicë. Ndërsa, për trajtimin e ujërave të ndotura, ndërmarrja disponon edhe një impiant të dedikuar për këtë qëllim. Impiantet e trajtimit të ujit:

Impiantet për trajtimin e ujit (ITU)

Nr	Emri i ITU	Komuna	Viti i ndërtimit /funksionalizimit	Kapaciteti (l/s)	Statusi
1	ITU Shipol	Mitrovicë	2014	750 l/s	Aktiv – furnizon Mitrovicën, Mitrovicën Veriore, Zveqanin dhe Skenderajn
2	ITU Balinc	Vushtrri	2016	350 l/s	Aktiv – furnizon qytetin dhe fshatrat e Vushtrrisë
3	ITU Zubin Potok	Zubin Potok	-	150 l/s	Aktiv – furnizon Zubin Potokun, një pjesë të Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore
4	Trajtimi i ujit	Leposaviq	-	30 l/s	Impianti aktual i papërfunduar, përderisa trajtohet uji edhe në dy pika tjera.



Figura 2. *Harta . Impiantet e trajtimit të ujit të pijes*

Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura

KRU "Mitrovica" operon me Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Llaushë (ITU-Llaushë) i cili mbulon një pjesë të zonës së Skenderajt deri në Tetor janë trajtuar 488,504 m3. Në këtë laborator bëhen analizat fiziko-kimike të ujërave të ndotura, dhe si I trajtuar i plotëson kushtet për tu shkarkuar në lum.

Ndërsa është në fazë zbatimi projekti madhor Impianti Rajonal Mitrovicë–Vushtrri, me vlerë investimi 39.3 milion € i financuar nga EBRD, EIB, WBIF dhe Qeveria e Kosovës.

Ky impiant do të mundësojë trajtim biologjik të ujërave të ndotura për zonat e Mitrovicës dhe Vushtrrisë dhe një pjesë e Zveçanit, duke ulur ndjeshëm ndikimin në mjedis.

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

Rrjeti përfshin linja primare, sekondare dhe degëzuese, me materiale të tipit AC, PE dhe PVC.

Sistemet mbështetëse:

- SCADA: në funksion në ITU Shipol, Balinc, ITU Zubin Potok me plan zgjerimi edhe në Leposaviq.

- GIS: funksional për 85.5% të rrjetit total të ujësjellësit në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, ndërsa komunat veriore janë në proces.

- Laboratori Qendror në Shipol: kryen analiza fiziko-kimike dhe duke filuar nga viti 2026 edhe bakteriologjike për kontroll të cilësisë së ujit, tani veq në proces akreditimi sipas ISO 17025.

Vlerësim i gjendjes teknike:

Rrjeti dhe impiantet janë funksionale, por kërkojnë investime në:

- rehabilitim të gypave AC dhe zonave me humbje të larta,
- modernizim të SCADA-s dhe ndërlidhje ndër-impiantore,
- efikasitet energjetik në pompime,
- ndërtim të rrjetit sekondar të kanalizimit në zonat rurale.

Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit

Njësia	Gjatësia e rrjetit të Ujësjellësit
Mitrovicë	523.24 km
Vushtrri	725.55 km
Skenderaj	417.00 km
Totali	1,665.48 km
Njësia	Gjatësia e rrjetit te Kanalizimit
Mitrovicë	164.00 km
Vushtrri	100.71 km
Skenderaj	17.49 km
Totali	282.20 km

Shenim: *Aktualisht mungojnë informata rreth rrjetit të ujit dhe kanalizimit në komunat veriore.*



Figura 3. Mbulueshmeria me sherbime-Shtrirja e KRU-Mitrovica SH.A

Kompania po zbaton projektet për:

- Segmentimin e rrjetit në zona DMA, dhe
- projektin rajonal për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura Mitrovicë–Vushtrri.

Kapaciteti aktual i prodhimit të ujit siguron mbulueshmëri të plotë të nevojave të popullsisë në rajonin e shërbimit, me përjashtim të Leposaviqit, ku gjatë sezonit veror paraqiten vështirësi serioze në furnizimin me ujë. Pavarësisht kapaciteteve ekzistuese, sfidat kryesore mbeten reduktimi i humbjeve të ujit (NRW) dhe rritja e efikasitetit energjetik.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve me komunat në pjesën veriore të Kosovës, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" ka filluar operimin aktiv në këtë zonë, me fokus në rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe ofrimin e shërbimeve sipas standardeve të njëjta për të gjithë qytetarët.

Funksionimi Aktual

KRU “Mitrovica” Sh.A. ka funksionalizuar strukturën organizative në njësitë operative veriore në përputhje me Planin Operativ të miratuar. Procesi i rekrutimit për pozitat e parapara ka përfunduar dhe stafi i angazhuar tashmë është në funksion të plotë në njësitë Mitrovicë e Veriut/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Funksionalizimi i stafit ka mundësuar forcimin e kapaciteteve operative, teknike, komerciale dhe administrative, duke mbështetur procesin e integrimit dhe ofrimin e rregullt të shërbimeve në komunat veriore.

Humbjet e ujit

Zvogëlimi i humbjeve të ujit përfaqëson një nga sfidat më të mëdha për kompaninë, duke qenë se mbi gjysma e ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në sistem mbetet e pafaturuar. Kjo përfshin humbje fizike, si rrjedhjet nga gypat, dhe humbje komerciale, si gabimet në matje dhe lidhjet (shfrytëzimet) ilegale, të cilat janë faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë fenomen. Ky nivel i lartë i ujit të pafaturuar shkakton humbje financiare, rrit kostot operative dhe zvogëlon efikasitetin e shfrytëzimit të ujit të prodhuar.

Për të përmbushur objektivin e zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe për të përmirësuar efikasitetin operacional, kompania do të përqendrohet në aktivitetet e mëposhtme:

- Identifikimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).
- Ndërtimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit për të garantuar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm.
- Mbulimi i plotë i konsumatorëve me ujëmatës, në koordinim me departamentin komercial, për të siguruar matje të saktë dhe të drejtë të konsumit.
- Zëvendësimi i 10,000 ujëmatësve që janë më të vjetër se 10 vjet, me qëllim të rritjes së saktësisë së matjes, përmirësimit të faturimit dhe reduktimit të humbjeve komerciale të ujit
- Rritja e efikasitetit operativ për të optimizuar proceset dhe për të ulur kostot e lidhura me humbjet e ujit.
- Organizimi i fushatave edukative dhe ndërgjegjësuese për kursimin e ujit, përdorimin racional dhe parandalimin e keqpërdorimit të tij, me qëllim të rritjes së vetëdijes qytetare për mbrojtjen e burimeve ujore.
- Identifikimi dhe evidentimi i kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe ndërmarrja e masave ligjore ndaj shkelësve, me qëllim të mbrojtjes së infrastrukturës, reduktimit të humbjeve, rritjes së cilësis së shërbimit dhe rritjes së inkasimit.

Këto aktivitete kontribuojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, si zvogëlimi i humbjeve të ujit, përmirësimi i efikasitetit operacional dhe rritja e cilësisë së furnizimit, duke u përpjekur për një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor për konsumatorët.

Mbulueshmëria me shërbime

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë Statistikore të Kosovës për popullsinë, menaxhmenti i kompanisë vlerëson se deri në vitin 2029, do të ketë një rritje të numrit të ekonomive familjare (konsumatorëve shtëpiak) në regjion. Kjo rritje do të rezultojë në një kërkesë të shtuar për ujë të pijshëm. Me kapacitetet aktuale të Impianteve të Trajtimit të Ujit në Shipol, Balinc dhe Zubin Potok, kompania është e përgatitur për të përballuar rritjen e pritur të kërkesës për ujë të pijshëm. Kapacitetet e këtyre impianteve mund të menaxhojnë me efikasitet furnizimin e nevojshëm për konsumatorët e rinj e atë gjithmonë duke siguruar një cilësi të lartë të shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Këto hapa strategjikë do të ndihmojnë KRU Mitrovica Sh.A. që të sigurojë shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë regjionin dhe të përmbushë nevojat në rritje të konsumatorëve të saj. Duke u bazuar në të dhënat e lartpërmendura parashikohet se deri në fund të vitit 2029 përqindja e mbulimit me shërbime të furnizimit me rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit do të jetë:

Me furnizim me ujë, mbi 90 % e regjionit të Mitrovicës dhe me rrjet të kanalizimit mbi 65 % nëse realizohet projekti ITUN.

Trajtimi i ujërave të ndotura do të rritet deri 65 %, marrë për bazë planifikimin e ndërtimit të Impiantit të ri për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) dhe kolektorëve kryesor dhe rrjetit sekondar të ujërave të ndotura që do të ndërtohet në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Mitrovicës Veriore dhe Zveçanit.

Zbulimi i rrjedhjeve

Me qëllim të realizimit të objektivave të ndërrmarrjes, do të intensifikojmë kërkimet në zbulimin e rrjedhjeve sidomos gjatë orëve të natës kur nëpër lokacione të ndryshme nuk ka zhurmë, konsumi i ujit është shumë i ulët, ndërsa presioni i ujit në tubacion i lartë gjë që e bënë më të lehtë zbulimin e rrjedhjeve nëntokësore, përmes pajisjeve zbuluese akustike. Ky aktivitet do të kryhet përmes caktimit të zonave tek të cilat dyshohet se ka shpenzim të lartë të ujit të pijes.

Prodhimi & Operimi në Impiante

Impiantet për trajtimin e ujit në Shipol, Balinc dhe Zubin Potok, parashihet që të vazhdojnë operimin e tyre normal. Impiantet e trajtimit të ujit, të gjithë qytetarëve të vet u garantojnë ujë cilësor, gjë e cila vërtetohet në bazë të analizave që kryhen në ITU si dhe verifikohen/konfirmohen nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP).

Përmes synimeve tona të lartcekura, planifikojmë uljen e kapaciteteve tona prodhuese duke mos cenuar në asnjë moment cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Kapacitetet prodhuese sipas ITU-ve

Impiantet per trajtimin e ujit te pijes	2026		2027		2028	
	Maksimal	Realizuar	Maksimal	Planifikim	Maksimal	Planifikim

ITU në Shipol	750 l/s	600 l/s	750 l/s	590 l/s	750 l/s	590 l/s
ITU në Vushtrri	350 l/s	200 l/s	350 l/s	190 l/s	350 l/s	190 l/s
ITU Zubin Potok	160 l/s	150l/s	160l/s	150l/s	160l/s	150l/s
Leposaviq	30 l/s	30l/s	30l/s	30l/s	30l/s	30l/s
Total	1,290 l/s	980 l/s	1,290 l/s	960 l/s	1,290 l/s	960 l/s

Cilësia e ujit të pijshëm në zonën e mbulimit të KRU "Mitrovica" Sh.A. është përgjithësisht brenda standardeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor, duke garantuar që konsumatorët furnizohen me ujë të sigurt dhe të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme. Analizat fiziko-kimike kryhen çdo katër orë në laboratorët e Impianteve të Trajtimit të Ujit (ITU) në Shipol, Balincë dhe Zubin Potok, ku monitorohen parametra si era, shija, turbullira, ngjyra, pH, klori i lirë, amoniaku, nitratet, nitrite dhe përçueshmëria elektrike. Rezultatet e këtyre analizave konfirmojnë se të gjithë treguesit janë brenda kufijve të lejuar për ujë të pijshëm, pa devijime që do të rrezikonin shëndetin publik. Përveç kontrollit të brendshëm, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) monitoron në mënyrë të pavarur parametrat bakteriologjikë dhe fiziko-kimikë përmes mostrimit të ujit në pika të ndryshme të rrjetit, duke përfshirë edhe njësitë e reja veriore. Kjo bashkëpunim ndërinstitucional siguron një sistem të dyfishtë verifikimi, i cili rrit besueshmërinë e të dhënave dhe garanton transparencë ndaj publikut.

Në aspektin teknik, sistemi i monitorimit synon modernizimin përmes integrimit të platformës SCADA, e cila mundëson mbikëqyrje online të parametrave si pH, temperatura, turbullira dhe klori i lirë në kohë reale. Po ashtu, KRU "Mitrovica" ka paraparë abonimin me sistemin LIMS (Laboratory Information Management System), i cili do të sigurojë ruajtje, analizë dhe raportim të centralizuar të të dhënave laboratorike. Në kuadër të planit zhvillimor, ndërmarrja ka rifunksionalizuar laboratorin qendror në Shipol dhe akreditimin e tij për parametrat kryesorë të cilësisë, si dhe për pajisjen e laboratorit mikrobiologjik me aparaturë të re dhe reagjentë specifikë. Këto masa do të mundësojnë realizimin e analizave të plota bakteriologjike brenda kompanisë, duke reduktuar varësinë nga institucionet e jashtme dhe duke përmirësuar shpejtësinë e reagimit në rastet emergjente. Në përfundim, cilësia e ujit të ofruar nga KRU "Mitrovica" është e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet ligjore. Megjithatë, përmirësimet e planifikuara në laboratorët e brendshëm, digjitalizimi i sistemit të monitorimit dhe akreditimi i laboratorit qendror pritet të rrisin më tej efikasitetin, transparencën dhe besueshmërinë në garantimin e ujit të pijshëm për të gjithë konsumatorët e rajonit.

3.3. Analiza financiare

Rezultatet 8-mujore të vitit 2026 paraqesin një performance relativisht të qëndrueshme financiare dhe komerciale për KRU "Mitrovica", përkundër rritjes së shpenzimeve sidomos me ngritjen e çmimeve

dhe zgjerimin e ndërrmarrjes me integrim të veriut. Edhe pse në veri ende nuk ka filluar Faturimi i tërë konsumatorëve gjendja financiare e kompanisë vazhdon të jetë me mbulim operativ pozitiv. Po ashtu kompania ka siguruar financim nga Ministria e Ekonomisë për projektet kapitale të kërkuara duke lehtësuar barrën financiare. Mbetet barrë e rëndë për kompaninë borxhet e akumuluara të faturimit me shumicë të cilat arrijnë vlerën rreth 20 milion euro. Sa i përket shpenzimeve sidomos shpenzimeve të pagave si shpenzimi kryesor i ndërrmarrjes nuk kemi pasuar asnjëherë veshtirësi në ekzekutim edhe pse stafi për veri është rekrutuar dhe janë rritur shpenzimet.

Faturimi/inkasim								
Plani i Faturimi në Euro për 2026								
Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Plani I Biznesit	573,038	565,408	541,481	559,402	580,891	572,388	644,098	703,548
Realizimi	542,289	522,184	540,882	573,108	550,558	553,485	625,638	687,871
% e realizimit	95%	92%	100%	102%	95%	97%	97%	98%
Plani I Inkasimit 2026								
Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Plani I Biznesit	601,314	593,302	568,178	586,996	609,559	600,631	675,927	738,349
Realizimi	422,267	475,599	551,370	527,759	491,623	553,552	623,941	747,609
% e realizimit	70%	80%	97%	90%	81%	92%	92%	101%

3.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SWOT dhe metodologjinë e katër faktorëve; fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Këta faktorë kanë të bëjnë me rritjen e kompanisë, produkteve, shërbimeve dhe objektivave të kompanisë në konkurrencën e tregut. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm: përparësitë dhe dobësitë dhe kanë të bëjnë me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj, kurse dy faktorët tjerë: mundësitë dhe rreziqet paraqesin faktorët e jashtëm dhe të njëjtit varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura KRUM do të tentoj të minimizoj dobësitë dhe rreziqet, duke përmirësuar në vazhdim teknologjinë e punës, avancuar/trajnuar stafin, qasje të vazhdushme proaktive ndaj borgjlinjeve, etj., e po ashtu të maksimizoj përparësitë dhe mundësit duke përmirësuar dhe zgjeruar në vazhdim shërbimin ndaj konsumatorit, duke ofruar mundësi zhvillimi profesional përmes punës praktike dhe punësimit për kuadrot e reja dhe profesionale.

Përparësitë:

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit,
- Infrastrukturë të trashëguar të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Operatori i vetëm i licencuar, konsumatorë të besueshëm, shitje të garantuar,
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese; Impianti në Shipol dhe Balinc dhe Zubin Potok.

Dobësitë:

- Teknologji e vjetërsuar,
- Mosha e shtyrë e fuqisë punëtore,
- Të arketueshmet e akumuluara,
- Humbjet e mëdha teknike dhe komerciale,

Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve,
- Mbështetje nga Partnerët,
- Zhvillimin e shërbimeve të reja lehtësuese për konsumatorin,
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit,
- Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit të ujit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave,
- Bazë e mirë ligjore për procedim të lëndëve të ndryshme në Gjykatë apo përmes Përmbaruesve Privat,
- Infrastrukturë ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU),

Rreziqet:

- Ngritja e tensioneve sociale apo politike,
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.),
- Vjetërsia e rrjetit,
- Gjendja e vështirë ekonomike dhe niveli i lartë i rasteve sociale në regjionin e Mitrovicës,
- Llogaritë e arkëtueshme të larta.

4. VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

4.1. Vizioni

KRU “Mitrovica” synon të jetë një kompani moderne dhe e qëndrueshme që garanton furnizim të sigurt, cilësor dhe të pandërprerë me ujë të pijshëm, si dhe menaxhim efikas të ujërave të ndotura në përputhje me standardet më të larta të Bashkimit Evropian. Duke Integruar teknologji të avancuara për trajtim dhe monitorim në kohë reale, kompania angazhohet për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e cilësisë së lartë të ujit për çdo konsumator.

Si pjesë e Rajonit të Ujit të Danubit, KRU “Mitrovica” është e përkushtuar të zbatojë praktikat më të mira evropiane, të nxisë inovacionin dhe të përmirësojë vazhdimisht shërbimet ndaj konsumatorëve, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

4.2. Misioni

Të sigurojmë furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm, menaxhim efikas të ujërave të ndotura dhe mbrojtje të burimeve ujore, përmes operimit profesional, transparencës, përgjegjësisë sociale dhe përfshirjes së komunitetit.

4.3. Vlerat Themelore

Vlerat themelore të KRU “Mitrovica” përfaqësojnë bazën mbi të cilën ndërtohet çdo veprim, vendim dhe strategji e kompanisë. Në qendër të këtyre vlerave qëndron integriteti, që udhëheq mënyrën e menaxhimit dhe shërbimit publik me ndershmëri, transparencë dhe përgjegjësi. Profesionalizmi është themeli i performancës së lartë, duke u bazuar në kompetencë, përkushtim dhe efikasitet në çdo nivel organizativ. Inovacioni dhe përmirësimi i vazhdueshëm udhëheqin zhvillimin teknologjik dhe operacional, duke nxitur digjitalizimin dhe përdorimin e praktikave bashkëkohore në menaxhimin e ujit dhe ujërave të ndotura. Po ashtu, ndërmarrja promovon bashkëpunimin dhe respektin reciprok, si brenda stafit ashtu edhe me konsumatorët, partnerët dhe institucionet, duke ndërtuar marrëdhënie të bazuara në besim dhe komunikim të hapur. Një nga vlerat kyçe mbetet përgjegjësia shoqërore dhe mjedisore, përmes së cilës KRU “Mitrovica” synon të mbrojë burimet natyrore, të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe të sigurojë një shërbim publik që reflekton etikë, kujdes dhe respekt ndaj qytetarëve dhe mjedisit

Objektivat Strategjikë

- Zvogëlimin e shkallës së ujit të pa faturuar nën 63 %
- Cilësinë e ujit të pijes sipas standardeve,
- Mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin e ujit dhe kanalizimit, me qëllim të ofrimit të një shërbimi sa më cilësor,

- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 100 %
- Ngritjen e normës së punës në 1.20
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.00
- Integrimin dhe shtrirjen e plotë në zonën e shërbimit të Komunave veriore

5. STRATEGJITË KRYESORE ZHVILLIMORE

Strategjia e zhvillimit të KRU "Mitrovica" për periudhën 2027–2029 mbështetet në pesë shtylla themelore të cilat përfaqësojnë boshtin e menaxhimit modern të ndërmarrjes: strategjia financiare, teknike, për konsumatorët, për burimet njerëzore dhe për inovacionin digjital.

5.1. Strategjia Financiare

Në kuadër të objektivave të përgjithshme të ndërmarrjes për periudhën 2027–2029, Departamenti i Financave do të zbatojë një strategji të orientuar drejt stabilitetit dhe vetëqëndrueshmërisë financiare, me synim garantimin e ekuilibrit afatgjatë ndërmjet të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve kapitale. Strategjia përfshinë masa konkrete për eliminimin e gjetjeve të auditorëve, përmes forcimit të kontrollit të brendshëm financiar, përmirësimit të procesve në kontabilitet dhe financa dhe zbatimit të plotë të rekomandimeve të auditimit.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme është përmirësimi i procedurave që lidhen me financat, me qëllim standardizimin e praktikave buxhetore dhe rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve. Po ashtu, departamenti do të investojë në avancimin e sistemit të softuerit financiar dhe kontabël, për të mundësuar automatizim të proceseve, integrim të modulit të aseteve dhe raportim më të saktë në kohë reale. Në të njëjtën linjë, do të thellohet menaxhimi profesional i aseteve, përmes regjistrimit, kontrollit dhe rivlerësimit periodik sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IAS/IFRS).

5.2. Strategjia Teknike dhe Operative

Kjo strategji synon rritjen e efikasitetit të rrjetit dhe uljen e humbjeve përmes investimeve në teknologji moderne dhe mirëmbajtjes preventive.

Prioritetet kryesore janë:

- Të hartohen dhe zbatohen projektet prioritare sipas Planit të Investimeve 2027–2029.
- Përdorimi i sistemit GIS për hartëzimin e rrjetit dhe menaxhimin e aseteve;
- Instalimi i ujëmatësave inteligjentë për zonat DMA, për reduktimin e ujit të pafaturuar;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues dhe ndërtimin e rrjeteve të reja
- Zhvillimi i sistemeve të kontrollit të konsumit energjetik nëpër stacione pompimi.

- Të përditësohet dhe zbatohet Plani i Menaxhimit të Aseteve (PMA) si dokument bazë për prioritetet investive të viteve 2027–2029.
- Të kryhet inventarizimi dhe digjitalizimi i plotë i aseteve teknike në GIS.
- Të harmonizohen të dhënat me ARRU dhe me raportimet e performancës (KPI).
- Të monitorohet zbatimi teknik dhe financiar i projekteve sipas standardeve të prokurimit publik dhe kërkesave të BE-së.)

5.3. Strategjia për Konsumatorët

Deri në fund të vitit 2028–2029, KRU "Mitrovica" Sh.A. synon të krijojë një sistem të konsoliduar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të konsumatorëve, të bazuar në regjistrimin dhe kontraktimin e plotë të tyre, saktësinë e të dhënave, funksionalizimin e ujëmatësve, faturimin sipas konsumit real, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe rritjen e nivelit të arkëtimit.

Për realizimin e këtyre objektivave, strategjia mbështetet në pesë drejtime kryesore:

a) Regjistrimi dhe konsolidimi i bazës së konsumatorëve – identifikimi, regjistrimi dhe kontraktimi i konsumatorëve, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i të dhënave për krijimin e një baze të saktë, të plotë dhe të besueshme.

b) Matja reale dhe faturimi i saktë – zgjerimi i mbulueshmërisë me ujëmatës funksionalë, sigurimi i leximit të rregullt dhe faturimi sa më i madh sipas konsumit real, duke reduktuar faturimin e bazuar në vlerësime.

c) Përmirësimi i shërbimit ndaj konsumatorëve – trajtimi me kohë, transparencë dhe efikasitet i kërkesave dhe ankesave, përmirësimi i komunikimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë së konsumatorëve.

d) Menaxhimi i borxheve dhe rritja e arkëtimit – forcimi i aktiviteteve për informimin e konsumatorëve, lidhjen e marrëveshjeve për pagesë me këste, riprogramimin e obligimeve dhe zbatimin e masave të lejuara ligjërisht, me qëllim uljen graduale të borxheve dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë.

f) Digjitalizimi, komunikimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve – zhvillimi dhe përdorimi i kanaleve digjitale për pagesa, kërkesa, ankesa dhe informim, si dhe organizimi i aktiviteteve vetëdijesuese për pagesat e rregullta, përdorimin racional të ujit dhe mbrojtjen e rrjetit publik.

Zbatimi i këtyre drejtimeve do të mbështetet në monitorimin e vazhdueshëm të treguesve të performancës, me qëllim matjen e progresit në regjistrimin e konsumatorëve, mbulimin me ujëmatës, saktësinë e faturimit, trajtimin e kërkesave dhe ankesave, si dhe përmirësimin e arkëtimit.

Objektivi përfundimtar është krijimi i një sistemi transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të menaxhimit komercial, që siguron të dhëna të besueshme, faturim të drejtë, shërbim cilësor dhe marrëdhënie afatgjata me konsumatorët në të gjitha njësitë operative të KRU “Mitrovica” Sh.A

5.4. Strategjia për Burimet Njerëzore

KRU “Mitrovica” Sh.A., në kuadër të Planit të Biznesit 2027–2029, synon të zhvillojë një sistem modern, funksional dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të burimeve njerëzore, në përputhje me zgjerimin e shtrirjes operative të Kompanisë, zhvillimin e infrastrukturës dhe nevojën për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve.

Strategjia do të fokusohet në sigurimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore, planifikimin e rekrutimeve dhe zëvendësimeve sipas nevojave operative dhe mundësive financiare, avancimin e kompetencave profesionale të punonjësve, si dhe digjitalizimin e proceseve të menaxhimit të personelit. Njëkohësisht, synohet forcimi i një kulture organizative të orientuar drejt performancës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Prioritetet strategjike për periudhën 2027–2029 përfshijnë:

Zhvillimin profesional dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve përmes programeve të strukturuara të trajnimit.

Planifikimin dhe plotësimin gradual të pozitave të nevojshme, në përputhje me kërkesat operative dhe kapacitetet financiare të Kompanisë.

Forcimin e funksionit të Burimeve Njerëzore dhe avancimin e proceseve të menaxhimit të personelit.

Digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve përmes zbatimit të një sistemi të integruar për menaxhimin e burimeve njerëzore (HRIS).

Përmirësimin e sistemit të vlerësimit të performancës dhe ndërlidhjen e tij me zhvillimin profesional dhe avancimin në karrierë.

Planifikimin e vazhdimësisë dhe zëvendësimin e stafit në pozitat kritike.

Promovimin e barazisë gjinore dhe garantimin e mundësive të barabarta për zhvillim profesional dhe avancim.

Plani i trajnimeve dhe zhvillimit profesional 2027–2029

Një komponent i rëndësishëm i kësaj strategjie është zhvillimi dhe aftësimi profesional i punonjësve. Për këtë qëllim, në bazë të nevojave të identifikuara nga departamentet dhe njësitë organizative është hartuar Plani i Trajnimeve dhe Zhvillimit Profesional për periudhën 2027–2029.

Planifikimi i trajnimeve është hartuar duke marrë parasysh nevojat aktuale dhe të ardhshme të Kompanisë, zgjerimin territorial të shërbimeve, funksionalizimin e plotë të njesive të reja operative, zhvillimet teknologjike dhe infrastrukturore, si dhe nevojën për ngritjen e vazhdueshme të kompetencave profesionale të personelit.

Prioriteti i trajnimeve është përcaktuar në bazë të rëndësisë së tyre për vazhdimësinë e operimeve, sigurinë e punonjësve, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për funksionimin e strukturës së zgjeruar të Kompanisë. Pjesa më e madhe e aktiviteteve janë klasifikuar me prioritet të lartë ose shumë të lartë dhe parashihen të realizohen përmes trajnimeve të brendshme, trajnimeve profesionale teorike dhe praktike, trajnimeve në terren dhe programeve të specializuara nga ofrues të jashtëm.

Realizimi i Planit të Trajnimeve do të bëhet në mënyrë graduale gjatë periudhës 2027–2029, në përputhje me prioritetet operative, disponibilitetin e programeve përkatëse dhe mundësitë buxhetore të Kompanisë.

Nr.	Tema/fusha e trajnimit	Grupi i synuar	Viti
1	Siguria dhe Shëndeti në Punë si dhe përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse – trajnim vjetor	Regjionale (të gjitha njësitë)	2027–2029
2	Puna e sigurt në rrjet, në gërmime dhe me makineri të rënda	Shefi i rrjetit, ujëinstalues, kanalizatorë, punëtorë fizikë, operatorë ekskavatori	2027
3	Mbrojtja nga zjarri, ndihma e parë, evakuimi dhe menaxhimi i emergjencave	Regjionale (të gjitha njësitë)	2027–2029
4	Vlerësimi i riskut për çdo pozitë pune	Regjionale (të gjitha njësitë)	2027
5	Veprimi në situata emergjente, defekte dhe avari	Dispeçerë, dozues, mirëmbajtje (Fabrika e Ujit Zubin Potok); ekipet e rrjetit (NjO Mitrovica e Veriut dhe Zveçan)	2027–2028
6	Mirëmbajtja dhe intervenimi në rrjetin e ujësjellësit e kanalizimit, përfshirë riprofilizimin	Punëtorë të mirëmbajtjes dhe punëtorë fizikë	2027
7	Kurs teorik dhe praktik për ujëinstalues	Njësit Operative	2027
8	Detektimi i rrjedhjeve me pajisje moderne – furnizim me pasjisje moderne pastaj dhe trajnim me ato pajisje	Detektues të rrjedhjeve; punëtorët e rrjetit	2027
9	Teknologjitë e reja të punës dhe eliminimi i defekteve	Departamenti Teknik	2027–2029
10	Përdorimi, mirëmbajtja, verifikimi dhe kalibrimi i pajisjeve dhe instrumenteve laboratorike	Laborantët	2027
11	Mostrimi, ruajtja, transporti, pranimi dhe gjurmueshmëria e mostrave; trajtimi i sigurt dhe	Laborantë, mostrues, dozues	2027

	dozimi i kimikateve; përgatitja dhe dozimi i polielektrolitit; validimi dhe verifikimi i metodave fiziko-kimike sipas ISO; analizat mikrobiologjike të ujit; menaxhimi dhe asgjësimi i mbetjeve kimike dhe mikrobiologjike; digjitalizimi i proceseve dhe menaxhimi elektronik i të dhënave laboratorike		
12	Leximi korrekt i ujëmatësve dhe evidentimi i anomalive; regjistrimi i konsumatorëve dhe puna me bazën e të dhënave; kontratat e shërbimit dhe procedurat administrative; kontrolli i konsumit dhe identifikimi i parregullsive e keqpërdorimeve; përmirësimi i kontrollit dhe harmonizimi i të dhënave sistem–terren; komunikimi me konsumatorët dhe sjellja profesionale në terren; trajnim i avancuar për shqyrtimin e ankesave – Niveli 2; menaxhimi i borxheve, kontratat e riprogramimit dhe rritja e inkasimit; mbrojtja e të dhënave personale	Departamenti Komercial – Regjionale (të gjitha njësitë)	2027–2029
13	GIS, menaxhimi i të dhënave të konsumatorëve dhe integrimi GIS–Billing; ArcGIS – module të avancuara dhe analiza hapësinore; WaterCAD – modelimi hidraulik i rrjetit; Urbano Canalis – projektimi i rrjeteve; GPS/GNSS – furnizim dhe trajnim	Departamenti Teknik dhe Departamenti Komercial	2027–2029
14	SCADA, sistemet e kontrollit automatik dhe konfigurimi i PLC-ve; konfigurimi i rrjeteve dhe bazat e të dhënave SQL	Stafi i IT-së; dispeçerë dhe dozues të Fabrikës së Ujit	2027–2029
15	Zhvillimi dhe integrimi profesional i BNJ dhe interpretimi i ligjeve; Akademia për burime njerëzore; menaxhimi i dosjeve të personelit, procedurat disiplinore dhe ankesat në marrëdhënie pune; administrimi i zyrës dhe menaxhimi i dokumentacionit elektronik e fizik	Departamenti i Administratës	2027–2029
16	**Kontabiliteti financiar, financat publike dhe raportimi profesional; inventarizimi, kapitalizimi dhe trajtimi i pasurive; etika profesionale**	**Departamenti Financiar**	2027–2028

Indikatorët kryesorë të performancës për Burimet Njerëzore

Për monitorimin e zbatimit të strategjisë së burimeve njerëzore janë përcaktuar indikatorët në vijim, të cilët do të raportohen sipas njësive operative, me ndarje të veçantë për njësitë veriore, dhe do t'i

paraqiten menaxhmentit çdo muaj e Bordit të Drejtorëve çdo tremujor, ndërsa për indikatorët që nuk janë matur deri më tani gjendja fillestare do të përcaktohet gjatë vitit 2027.

Nr.	Indikatori	Mënyra e llogaritjes	2026	2027	2028	2029
Planifikimi dhe efikasiteti i stafit						
1	Numri i punonjësve	Gjendja në muajin Shtator	349	380	380	380
2	Punonjës për 1,000 konsumatorë të regjistruar	Punonjës / konsumatorë × 1,000	6.06	4.98	4.93	4.88
4	Koha mesatare e rekrutimit	Ditë nga shpallja deri te punësimi	–	≤ 75	≤ 75	≤ 75
5	Qarkullimi i stafit	Largime vullnetare / numri mesatar i punonjësve	–	≤ 5%	≤ 5%	≤ 5%
6	Mungesat për shkak të sëmundjes	Ditë mungese / ditë pune gjithsej	–	≤ 4%	≤ 3.5%	≤ 3%

Indikatori i punonjësve për 1,000 konsumatorë për vitin 2026 është llogaritur mbi 57,588 konsumatorë të regjistruar në qershor 2026, ndërsa vlerat për periudhën 2027–2029 bazohen në planin e stafit dhe në numrin e planifikuar të konsumatorëve, me ç'rast ulja graduale e këtij raporti tregon se rritja e bazës së konsumatorëve, sidomos në njësitë veriore, duhet të jetë më e shpejtë se rritja e numrit të punonjësve

5.5. Strategjia për Inovacion dhe Digjitalizim

KRU "Mitrovica" Sh.A. synon të avancojë drejt një modeli modern operimi përmes zbatimit të teknologjive inteligjente dhe proceseve të automatizuara që rrisin efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve. Në këtë kuadër, strategjia e digjitalizimit bazohet në pesë drejtime kryesore zhvillimore:

Digjitalizimi i proceseve operative: Zbatimi i sistemeve moderne SCADA për monitorim dhe kontroll në kohë reale të impianteve të ujit, automatizimi i pompave, valvulave dhe matësve të presionit, me qëllim rritjen e efikasitetit energjetik dhe uljen e humbjeve operative.

Transformimi digjital i shërbimeve ndaj konsumatorëve: Krijimi i një platforme online të integruar për faturim, pagesa elektronike dhe komunikim dypalësh me konsumatorët, duke mundësuar transparencë, akses më të lehtë në informacione dhe shërbim të personalizuar.

Përmirësimi i vendimmarrjes përmes analizës së të dhënave: Krijimi i një baze të integruar të të dhënave operacionale dhe financiare, si dhe zhvillimi i mjeteve analitike dhe raporteve dinamike për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe planifikimit afatgjatë.

Inovacion në menaxhim dhe zhvillim të kapaciteteve: Investime të vazhdueshme në trajnimin e stafit teknik dhe administrativ, bashkëpunim me institucione akademike, donatorë ndërkombëtarë dhe partnerë teknologjikë, për të nxitur kulturën e inovacionit dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm institucional.

5.6 STRATEGJIA E INTEGRIMIT TË KOMUNAVE VERIORE

Në kuadër të zgjerimit të zonës së operimit dhe forcimit të rolit institucional të ndërmarrjes, KRU "Mitrovica" Sh.A. ka ndërmarrë procesin e integrimit të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit në sistemin e saj të menaxhimit dhe ofrimit të shërbimeve. Procesi mbështetet në marrëveshjet e nënshkruara me komunat përkatëse, marrjen e përgjegjësive operative dhe licencimin nga ARRU për ofrimin e shërbimeve në këto zona. Integrimi përbën një nga prioritetet kryesore strategjike të ndërmarrjes dhe ndërlidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e mbulueshmërisë, krijimin e një sistemi unik të shërbimit dhe sigurimin gradual të qëndrueshmërisë operative dhe financiare.

Strategjia zbatohet sipas një qasjeje graduale, duke kaluar nga funksionalizimi i njësive dhe krijimi i kapaciteteve njerëzore e operative, në identifikimin dhe regjistrimin e konsumatorëve, vendosjen dhe verifikimin e ujëmatësve, lidhjen e kontratave të shërbimit dhe përfshirjen graduale të konsumatorëve në sistemin e faturimit dhe inkasimit. Kjo qasje është në përputhje me Planin Operacional për Njësitë Veriore, i cili synon krijimin e një baze të saktë dhe të verifikuar të konsumatorëve dhe vendosjen graduale të matjes, faturimit dhe inkasimit sipas gatishmërisë së zonave dhe kategorive të konsumatorëve.

Procesi i integrimit komercial është në zhvillim dhe deri më 2 tetor 2026 ka shënuar progres të konsiderueshëm. Nga një bazë e parashikuar prej rreth 17,000 konsumatorësh, janë identifikuar 8,366 konsumatorë, prej të cilëve 6,848 janë regjistruar, ndërsa janë raportuar 6,761 kontrata shërbimi dhe 1,994 ujëmatës të vendosur. Procesi po vazhdon në të tri njësitë operative veriore dhe bashkëpunimi ndërmjet njësive, stafit lokal dhe ekipeve mbështetëse vlerësohet përgjithësisht i kënaqshëm, duke krijuar bazë të mirë për përshpejtimin e fazave të ardhshme të integrimit.

Regjistrimi do të vazhdojë në mënyrë të planifikuar sipas zonave prioritare, përmes zyrave lokale dhe ekipeve në terren. Për secilin konsumator synohet verifikimi i të dhënave identifikuese, kategorisë së konsumatorit, pikës së furnizimit, gjendjes së lidhjes dhe ujëmatësit, si dhe integrimi i të dhënave në sistemet përkatëse të kompanisë. Në aspektin organizativ, njësitë veriore tashmë kanë një bazë të konsiderueshme të kapaciteteve njerëzore, me rreth 104 punonjës, ndërsa funksionet komerciale dhe Zyra e Faturimit janë përforcuar për të mbështetur regjistrimin, kontraktimin dhe përpunimin e konsumatorëve në sistem.

Një komponent i rëndësishëm i strategjisë është informimi dhe komunikimi me konsumatorët. Komunikimi do të zhvillohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe dygjuhëshe, përmes zyrave dhe ekipeve në terren, mediave, kanaleve digjitale, komunave, institucioneve dhe përfaqësuesve të komuniteteve. Qëllimi është që procesi të fokusohet në ofrimin e shërbimit të rregullt, matjen e drejtë, faturimin transparent dhe trajtimin e barabartë të konsumatorëve, duke ndërtuar gradualisht besimin dhe disiplinën e pagesave. Kjo qasje është në përputhje me parimet e përcaktuara në Planin Operacional për gjithëpërfshirjen, dygjuhësinë, transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit

Në aspektin komercial dhe financiar, objektivi kryesor është kalimi gradual drejt faturimit individual të konsumatorëve finalë, duke zëvendësuar modelin e mëparshëm të faturimit me shumicë aty ku ai është aplikuar. Procesi i përfshirjes në sistemin e faturimit tashmë ka filluar dhe do të zgjerohet progresivisht, në përputhje me gatishmërinë e bazës së konsumatorëve, verifikimin e të dhënave dhe gjendjen e matjes. Sipas raportit të progresit, në Mitrovicë të Veriut/Zveçan dhe Zubin Potok, 382 konsumatorë ishin përfshirë në sistemin e faturimit dhe 1,701 raste ishin në pritje për përpunim, ndërsa për Leposaviqin procesi ishte në fazën e përgatitjes së lëndëve për futje në sistem.

Paralelisht me zhvillimin komercial, strategjia parasheh përmirësimin gradual të infrastrukturës dhe matjes. Prioritet mbetet instalimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve, identifikimi i zonave me humbje të larta, rehabilitimi i pjesëve prioritare të rrjetit, instalimi i matësve kryesorë dhe zonalë dhe përmirësimi i monitorimit të sistemit. Deri në fillim të tetorit 2026 janë raportuar 1,994 ujëmatës të vendosur, prej tyre 1,097 në Mitrovicë të Veriut/Zveçan, 405 në Zubin Potok dhe 492 në Leposaviq. Investimet e mëtejshme do të prioritizohen sipas nevojave të identifikuara në terren dhe mundësive financiare të ndërmarrjes, duke synuar edhe mbështetje nga institucionet, grantet dhe donatorët për projektet me vlerë më të lartë.

Integrimi i njësive veriore paraqet njëkohësisht një mundësi zhvillimore dhe një sfidë të rëndësishme financiare e operative. Për këtë arsye, KRU “Mitrovica” do të monitorojë në vazhdimësi ritmin e identifikimit dhe regjistrimit, instalimin e ujëmatësve, përfshirjen e konsumatorëve në sistemin e faturimit, nivelin e faturimit dhe arkëtimit, kostot operative dhe treguesit e performancës teknike. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përshpejtimit të matjes dhe përpunimit të konsumatorëve në sistem, të cilat paraqesin parakushte për zgjerimin e faturimit dhe krijimin gradual të të hyrave nga këto njësi.

Në kuadër të Planit të Biznesit 2027–2029, objektivi përfundimtar mbetet krijimi i një sistemi të integruar dhe të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimeve në të gjithë zonën e operimit të KRU “Mitrovica”, me standarde të njëjta të shërbimit për të gjithë konsumatorët, bazë të konsoliduar të konsumatorëve, matje dhe faturim të rregullt, rritje graduale të arkëtimit dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës teknike dhe financiare. Zbatimi i strategjisë do të monitorohet periodikisht nga Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve dhe do të përshtatet sipas progresit real të procesit dhe nevojave të identifikuara gjatë zbatimit.

Plani i aktiviteteve për integrimin e veriut

GANTT CHART

KRU "Mitrovica" Sh.A. | Periudha e propozuar: 2026 – Dhjetor 2027

Nr.	Veprimi	Mars 2027	Prill 2027	Maj 2026	Qershor 2026	Korrik 2026	Gusht 2026	Shtator 2026	Tetor 2026	Nëntor 2026	Dhjetor 2026	Janar 2027	Shkurt 2027	mars 2027	Prill 2027	Maj 2027	Qershor 2027	Korrik 2027	Gusht 2027	shtator 2027	Tetor 2027	Nentor 2027	Dhjetor 2027
1	Regjistrimi vullnetar në zyrat lokale	•	•	•																			
2	Regjistrimi në terren me ekipe mobile		•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
3	Broshura/fletushka informuese		•	•			•		•		•		•		•		•		•		•		•
4	Përgatitja e faturës dygjuhëshe dhe testimi i sistemit	•	•	•																			
5	Faturimi i institucioneve				•																		
6	Faturimi i bizneseve							•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
7	Pilotimi i faturimit me amvisëri								•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
8	Zgjerimi gradual i faturimit per te gjitha kategoritë								•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
9	Inkasimi gradual për të gjitha kategoritë									•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
10	Faturimi sipas konsumit mesatar mujor per konsumatoret pa ujemates									•	•	•	•	•	•								
11	Monitorim i rregullt i mekanizmit të ankesave dhe raportimi					•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
12	Dashboard javor dhe review mujor	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•

6. PLANI OPERACIONAL / ZHVILLIMOR

Plani operacional për periudhën 2027–2029 përfaqëson dokumentin udhëzues për zbatimin e objektivave të Planit të Biznesit të KRU "Mitrovica" Sh.A., duke përcaktuar drejtimet kryesore të veprimit për njësitë dhe departamentet e ndërmarrjes. Fokusi kryesor do të jetë ruajtja e qëndrueshmërisë financiare, konsolidimi i operimit në të gjithë zonën e shërbimit, përmirësimi i efikasitetit teknik, reduktimi i ujit të pafaturuar, digjitalizimi i proceseve dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Në aspektin e burimeve njerëzore, periudha 2027–2029 do të karakterizohet nga konsolidimi i strukturës organizative pas zgjerimit të zonës së operimit dhe integrimit të njësive veriore. Numri i punëtorëve planifikohet të jetë rreth 380 në vitet 2027- 2029 duke reflektuar nevojat operative të ndërmarrjes, pensionimet, zëvendësimin e pozitave kritike dhe funksionalizimin e plotë të njësive. Vetëm në njësitë veriore tashmë janë angazhuar rreth 104 punonjës, përfshirë strukturën komerciale.

Digjitalizimi i menaxhimit të burimeve njerëzore do të mbështetet përmes investimeve në sistemin e hyrje/daljeve, menaxhimit të pagave dhe softuerit përkatës, duke përfshirë edhe njësitë veriore. Kjo do të mundësojë kontroll më të mirë të prezencës, administrimit të stafit dhe kostove të punës, si dhe lidhje më të mirë ndërmjet proceseve administrative dhe financiare.

Zhvillimi profesional i stafit mbetet një nga prioritetet e periudhës. Për vitin 2027 është planifikuar një buxhet prej 50,000 euro për trajnime, i orientuar në ngritjen e kapaciteteve teknike, financiare, komerciale, administrative dhe menaxheriale. Trajnimet do të përfshijnë sigurinë teknike dhe mjedisore, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve SCADA dhe GIS, mirëmbajtjen elektro-mekanike, teknikat laboratorike, shërbimin ndaj konsumatorëve, raportimin financiar sipas IAS/IFRS, përdorimin e sistemeve digjitale dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale

Buxheti sipas departamenteve

TRAJNIMI	BUXHETI/€
Departamenti Administrativ	8,000
Departamenti Teknik	12,000
IT	3,000
Cilësia e ujit	7,500
Departamenti Komercial	10,000
Departamenti Financiar	8,000
Njësia e Auditimit	1,500
Totali I Përgjithshëm	50,000

Një shtyllë e rëndësishme e Planit Operacional do të jetë digjitalizimi dhe integrimi i sistemeve të informacionit. Për vitin 2027 janë paraparë rreth 105,000 euro investime në IT, të cilat përfshijnë zhvillimin e sistemit të pagesave offline në pikat e arkëtimit, furnizimin me kompjuterë, monitorë, laptopë dhe printerë, pajisje për faturim mobil, UPS, sisteme të kamerave për objekte të kompanisë, pajisje për hyrje/dalje dhe paga, si dhe zhvillimin e moduleve në sistemet ERP dhe Billing dhe API-ve për ndërlidhjen e sistemit eKomerc me sistemet mikrofinanciare. Këto investime synojnë integrimin më të mirë të proceseve financiare, komerciale dhe operative dhe rritjen e sigurisë dhe gjurmueshmërisë së të dhënave.

Në aspektin teknik, prioritet do të jetë përmirësimi i kontrollit dhe monitorimit të rrjetit. Investimet përfshijnë zhvillimin e mëtejshëm të GIS-it dhe SCADA-s, pajisje për matje gjeodezike GPS, automatizimin e proceseve në impiantet e trajtimit të ujit, instalimin e pajisjeve dhe sensorëve për monitorim, si dhe përcaktimin gradual të zonave DMA. Në njësitë veriore, matja dhe krijimi i zonave të kontrollit do të zhvillohen paralelisht me instalimin e ujëmatësve dhe zgjerimin e faturimit, duke mundësuar monitorimin më të saktë të ujit të prodhuar, konsumit të faturuar dhe ujit të pafaturuar.

Një prioritet i veçantë gjatë vitit 2027 do të jetë konsolidimi i integrimit të njësive veriore. Procesi tashmë ka avancuar në identifikimin dhe regjistrimin e konsumatorëve, lidhjen e kontratave dhe vendosjen e ujëmatësve. Sipas gjendjes së 2 tetorit 2026, nga rreth 17,000 konsumatorë të parashikuar janë identifikuar 8,366, janë regjistruar 6,848, janë raportuar 6,761 kontrata shërbimi dhe janë vendosur 1,994 ujëmatës. Gjatë periudhës së planit procesi do të vazhdojë me regjistrimin e konsumatorëve të mbetur, instalimin e ujëmatësve dhe kalimin gradual në faturim dhe inkasim të rregullt. Për mbështetjen e këtij procesi, në planin e investimeve është përfshirë edhe furnizimi dhe instalimi i 10,000 ujëmatësve për amvisëri dhe biznese, krahas investimeve në infrastrukturën dhe kapacitetet operative të njësive veriore.

Në aspektin komercial, objektivi është zgjerimi i bazës së faturimit, rritja e arkëtimit dhe forcimi i disiplinës së pagesave. Numri i konsumatorëve të regjistruar planifikohet të rritet nga 76,374 në vitin 2027 në 77,909 në vitin 2029, ndërsa uji i faturuar nga 10.11 milionë m^3 në 10.73 milionë m^3. Faturimi planifikohet të rritet nga rreth 7.97 milionë euro në 2027 në 8.45 milionë euro në 2029, ndërsa arkëtimi nga 8.29 milionë euro në 8.79 milionë euro. Shkalla e planifikuar e arkëtimit prej 104% përfshin, krahas faturave rrjedhëse, edhe arkëtimin e borxheve të mëhershme.

Njëkohësisht, reduktimi i ujit të pafaturuar do të mbetet një nga sfidat kryesore të periudhës. Treguesi planifikohet të ulet nga 66.3% në vitin 2027 në 64.7% në 2028 dhe 63.6% në 2029. Arritja e këtyre objektivave do të mbështetet përmes rehabilitimit të rrjetit, zgjerimit të matjes, instalimit të ujëmatësve individualë dhe zonalë, krijimit të DMA-ve, përdorimit të GIS/SCADA dhe përmirësimit të kontrollit komercial.

Në aspektin financiar, prioritet mbetet kontrolli i shpenzimeve dhe ruajtja e likuiditetit në kushtet e zgjerimit të operimit. Shpenzimet operative pa amortizim planifikohen në 7.85 milionë euro në vitin 2027, 8.0 milionë euro në vitin 2028 dhe 8.16 milionë euro në vitin 2029, ndërsa norma e mbulesës së

punës planifikohet të përmirësohet gradualisht nga 1.03 në 1.05. Përmirësimi i ERP-së dhe integrimi i tij me sistemet e faturimit dhe proceset e tjera do të përdoret për forcimin e kontrollit buxhetor, raportimit financiar dhe monitorimit të realizimit të planit.

Në aspektin investiv, Plani përfshin projekte që lidhen me rehabilitimin e rrjetit, përmirësimin e impianteve, automatizimin, sigurinë e objekteve, energjinë, pajisjet operative dhe zgjerimin e kapaciteteve në veri. Për vitin 2027 janë paraparë 238,245 euro investime me mjete vetanake, ndërsa portofoli i përgjithshëm i projekteve të planifikuara, duke përfshirë financimet nga institucionet vendore, BERZH/BEI/WBIF dhe burime të tjera, arrin mbi 53 milionë euro. Në këtë kuadër përfshihet edhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, investimet fotovoltaike, rehabilitimi i rrjeteve dhe impianteve, përmirësimi i SCADA-s, investimet në laboratorë dhe projektet infrastrukturore në njësitë veriore.

Gjatë viteve 2028–2029, fokusi do të zhvendoset gradualisht nga zgjerimi dhe krijimi i kapaciteteve drejt konsolidimit dhe rritjes së efikasitetit. Prioritet do të jetë vazhdimi i reduktimit të ujit të pafaturuar, rritja e faturimit dhe arkëtimit, përfundimi dhe funksionalizimi i investimeve të nisura, përdorimi më i avancuar i sistemeve ERP, Billing, GIS dhe SCADA dhe përmirësimi i produktivitetit të burimeve njerëzore. Në fund të periudhës do të bëhet vlerësimi i realizimit të objektivave financiare, komerciale, teknike dhe organizative, si bazë për ciklin e ardhshëm të planifikimit strategjik dhe operacional.

Në tërësi, Plani Operacional 2027–2029 synon kalimin drejt një modeli gjithnjë e më të integruar, të digjitalizuar dhe të orientuar drejt performancës, ku zgjerimi i zonës së shërbimit shoqërohet me rritje të faturimit dhe arkëtimit, kontroll më të mirë financiar, reduktim gradual të humbjeve, modernizim të infrastrukturës dhe standarde të njëjta të shërbimit për konsumatorët në të gjitha njësitë operative.

7. PLANI FINANCIAR

Planifikimi financiar për periudhën 2027–2029 është ndërtuar mbi zgjerimin e aktivitetit të KRU "Mitrovica" Sh.A., konsolidimin e njësive operative veriore, rritjen graduale të bazës së konsumatorëve dhe nevojën për ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare përballë rritjes së kostove operative. Objektivi kryesor financiar mbetet sigurimi i të hyrave të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative, përmirësimi i arkëtimit dhe krijimi gradual i hapësirës financiare për investime dhe zhvillim të mëtejshëm.

Të hyrat totale pa tvsh të planifikuara për vitin 2027 arrijnë në rreth 8.87 milionë euro, prej të cilave 7.38 milionë euro nga shitja e ujit, 40 mijë euro nga shërbimet dhe rreth 1.45 milionë euro nga donacionet/të hyrat e shtyra. Në plan nuk janë paraparë të hyra nga subvencionet. Struktura e të hyrave tregon se aktiviteti bazë i ndërmarrjes mbetet burimi kryesor i financimit të operimit, ndërsa donacionet vazhdojnë të përbëjnë një burim të rëndësishëm mbështetës për ndërmarrjen.

Në anën e shpenzimeve, shpenzimet operative pa amortizim planifikohen në rreth 7.85 milionë euro në vitin 2027, 8.0 milionë euro në vitin 2028 dhe 8.16 milionë euro në vitin 2029. Kategoria me peshën më të madhe mbetet ajo e pagave, me rreth 4.25 milionë euro në vitin 2027, duke reflektuar rritjen e numrit të punëtorëve dhe konsolidimin e strukturës organizative pas zgjerimit të zonës së operimit. Shpenzimet e energjisë elektrike planifikohen në 2.20 milionë euro, ndërsa shpenzimet për Iber-Lepencin në 580 mijë euro, kimikalet në 125 mijë euro, mirëmbajtja në 150 mijë euro dhe kategoritë e tjera sipas nevojave të planifikuara operative. Për vitet 2028 dhe 2029 është aplikuar një rritje e përgjithshme e planifikuar e shpenzimeve prej rreth 2% në vit.

Performanca e arkëtimit përbën një prej elementeve kryesore të planit financiar. Për periudhën 2027–2029 planifikohet një normë prej rreth 104% të faturimit. Norma mbi 100% nuk nënkupton vetëm arkëtimin e faturimit të vitit përkatës, por përfshin edhe arkëtimin e borxheve të akumuluara nga periudhat e mëparshme. Në planifikimin për vitin 2027 është përdorur një normë më e lartë e arkëtimit për njësitë jugore, ku ekziston bazë e konsoliduar e faturimit dhe e borxheve, ndërsa për njësitë veriore është aplikuar një qasje më konservative, duke marrë parasysh se procesi i regjistrimit, matjes, faturimit dhe krijimit të disiplinës së pagesave është ende në konsolidim.

Pavarësisht rritjes së shpenzimeve, ndërmarrja planifikon të ruajë mbulim pozitiv të operimit gjatë gjithë periudhës. Norma e mbulesës së punës planifikohet në 1.03 në vitin 2027, 1.04 në vitin 2028 dhe 1.05 në vitin 2029. Diferenca ndërmjet arkëtimeve dhe shpenzimeve operative planifikohet pozitive në rreth 239 mijë euro në vitin 2027, duke u përmirësuar në rreth 327 mijë euro në vitin 2028 dhe 419 mijë euro në vitin 2029. Kjo tregon një përmirësim gradual të kapacitetit të ndërmarrjes për të financuar aktivitetin e saj operativ nga të hyrat e gjeneruara.

Në tërësi, Plani Financiar 2027–2029 paraqet një rritje graduale dhe të kontrolluar të aktivitetit financiar të ndërmarrjes. Rritja e faturimit dhe arkëtimit, konsolidimi i faturimit në njësitë veriore dhe përmirësimi gradual i normës së mbulesës krijojnë bazën për forcimin e qëndrueshmërisë financiare. Në të njëjtën kohë, rritja e shpenzimeve të personelit dhe energjisë, niveli i lartë i ujit të pafaturuar dhe nevojat e konsiderueshme për investime kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të kostove, përmirësim të efikasitetit operacional dhe realizim të disiplinuar të objektivave të faturimit dhe arkëtimit.

Të gjitha detajet numerike dhe pasqyrat përkatëse paraqiten në tabelat financiare të planit për vitet 2027–2029, të cilat shërbejnë si bazë për analizat e mësipërme.

Tarifat

Nivelet e çmimeve nominale të tarifave	Njësia	2026	2027
Ujë			
Shtëpiak –volumetrike	EUR/m3	**0.5324**	**0.5659**
Komercial-industrial-volumetrike	EUR/m3	**0.6291**	**0.6791**
Institucional-volumetrike	EUR/m3	0.6291	0.6791
Ujërat e zeza (vëllimi i ujit të konsumuar)			
Shtëpiak	EUR/m3	**0.1354**	**0.1422**
Komercial-industrial	EUR/m3	**0.2979**	**0.3129**
Institucional	EUR/m3	**0.2979**	**0.3129**
Tarifat komulative			
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	**0.6678**	**0.7081**
Jo-shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	**0.927**	**0.992**

Kompania jonë me datë 20 Tetor të këtij viti ka pranuar urdhëresën tarifore të re për vitin 2027 ku kemi një rritje të lehtë të tarifave duke reflektuar normën e inflacionit vjetor dhe rregullimet tjera nga ARRU.

7.1. Të ardhurat dhe shpenzimet operative

Departamenti i Financave i KRU “Mitrovica” Sh.A. është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), duke siguruar transparencë, saktësi dhe krahasueshmëri të të dhënave financiare. Të gjitha librat kontabël, regjistrimet e transaksioneve dhe evidencat tatimore mbahen në përputhje me Legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe me kërkesat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Raportimet financiare realizohen në baza mujore,

tremujore dhe vjetore, të cilat i nënshtrohen kontrollit të brendshëm dhe auditimeve të jashtme, duke garantuar besueshmëri në prezantimin e pozitës financiare dhe të performancës së kompanisë.

Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave 2027		
Përshkrimi	2026 parashikim 4 muaj	2027
TË HYRAT		
Të hyrat nga shitja e ujit	€6,295,062	€7,375,361
Të hyrat nga shërbimet	€36,979	€40,000
Të hyrat nga subvencionet	€0	€0
Të hyrat nga donacionet	€1,425,308	€1,450,308
TOTAL TË HYRAT	€7,757,349	€8,865,669
Kostoja e shitjes	€621,515	€705,000
FITIMI / (HUMBJA) BRUTO	€7,135,834	€8,160,669
SHPENZIMET OPERATIVE		
Shpenzimet e pagave	€3,422,756	€4,250,000
Shpenzimet e energjisë	€1,717,359	€2,200,000
Shpenzimet e karburanteve	€53,538	€65,000
Shpenzimet e mirëmbajtjes	€136,299	€150,000
Shpenzimet e komunikimit	€12,588	€20,000
Shërbimet e jashtme kontraktuese	€109,734	€253,850
Të tjera	€59,687	€203,000
Borxhet e fshira	€227,297	€200,000
Shpenzimet e zhvlerësimit	€2,509,052	€2,529,052
TOTAL SHPENZIMET OPERATIVE	€8,248,309	€9,870,902
FITIMI / (HUMBJA) OPERATIVE	(€1,112,475)	(€1,710,233)
FITIMI / (HUMBJA) E VITIT	(€1,112,475)	(€1,710,233)

Pasqyra e të ardhurave për vitin 2027 reflekton zgjerimin e aktivitetit të KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe rritjen e planifikuar të faturimit, por njëkohësisht edhe rritjen e kostove që shoqërojnë operimin në një zonë më të gjerë të shërbimit. Të hyrat totale planifikohen në 8.87 milionë euro, krahasuar me 7.76 milionë euro të parashikuara për vitin 2026, me një rritje prej rreth 1.11 milionë euro ose 14.3%. Kontributin kryesor në këtë rritje e japin të hyrat nga shitja e ujit, të cilat planifikohen të rriten nga 6.30 milionë euro në 7.38 milionë euro, si rezultat i rritjes së faturimit dhe përfshirjes graduale të konsumatorëve të njësive veriore në sistemin e rregullt të faturimit. Të hyrat nga shërbimet dhe donacionet mbeten relativisht stabile, ndërsa nuk janë planifikuar të hyra nga subvencionet.

Në anën e shpenzimeve, për vitin 2027 planifikohen 9.87 milionë euro shpenzime operative, përfshirë zhvlerësimin, krahasuar me 8.25 milionë euro në parashikimin e vitit 2026, që paraqet një rritje prej rreth 19.7%. Po ashtu, shpenzimet e energjisë elektrike planifikohen në 2.20 milionë euro, krahasuar

me 1.72 milionë euro në vitin 2026, duke vazhduar të përbëjnë një nga kategoritë me ndikimin më të madh në strukturën e kostove. Rritje janë planifikuar edhe në shërbimet e jashtme kontraktuese, karburante, mirëmbajtje, komunikim dhe shpenzime të tjera, në përputhje me nevojat e zgjeruara operative të kompanisë.

Si rezultat i strukturës së planifikuar të të hyrave dhe shpenzimeve, për vitin 2027 parashihet humbje operative dhe vjetore prej rreth 1.71 milionë euro, krahasuar me rreth 1.11 milionë euro të parashikuara për vitin 2026. Megjithatë, në vlerësimin e këtij rezultati duhet të merret parasysh ndikimi i konsiderueshëm i shpenzimeve të zhvlerësimit prej 2.53 milionë euro, të cilat përbëjnë shpenzim kontabël pa dalje të drejtpërdrejtë të parasë. Pa efektin e zhvlerësimit, rezultati operativ paraqitet pozitiv në vlerë prej rreth 819 mijë euro, çka tregon se të hyrat e planifikuara mbulojnë shpenzimet operative, pa përfshirë zhvlerësimin. Megjithatë, ky rezultat nuk përfaqëson domosdoshmërisht tepricë të parasë, pasi qëndrueshmëria financiare varet edhe nga realizimi i arkëtimeve, pagesa e detyrimeve dhe nevojat për investime.

Në tërësi, plani për vitin 2027 paraqet një vit të rritjes së aktivitetit dhe konsolidimit të operimit, ku rritja e faturimit dhe të hyrave duhet të shoqërohet me kontroll të vazhdueshëm të shpenzimeve, veçanërisht të pagave, energjisë dhe shërbimeve të jashtme kontraktuese. Përmirësimi i faturimit dhe arkëtimit në njësitë veriore, reduktimi i ujit të pafaturuar dhe menaxhimi më efikas i kostove do të jenë faktorët kryesorë për përmirësimin gradual të rezultatit financiar dhe forcimin e qëndrueshmërisë së ndërmarrjes.

Planifikimi i hyrjeve dhe daljeve të parasë të KRUM për vitet 2027-2029

Kategoria	2027	2028	2029
ARKËTIMI			
Arkëtimi i përgjithshëm	**€8,327,840**	**€8,577,675**	**€8,835,006**
Arkëtimi nga shërbimet bazë të ujit	€8,287,840	€8,536,475	€8,792,570
Arkëtimi nga shërbimet	€40,000	€40,000	€40,000
SHPENZIMET			
Shpenzimet e pagave	€4,250,000	€4,335,000	€4,421,700
Shpenzimet e energjisë	€2,200,000	€2,244,000	€2,288,880
Shpenzimet e karburanteve	€65,000	€66,300	€67,626
Shpenzimet e Iber Lepencit	€580,000	€591,600	€603,432
Shpenzimet e kemikaleve	€125,000	€127,500	€130,050
Shpenzimet e mirëmbajtjes	€150,000	€153,000	€156,060
Shpenzimet e komunikimit	€20,000	€20,400	€20,808
Shpenzimet e jashtme kontraktuese dhe tjera*	€698,850	€712,827	€727,084
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	**€8,088,850**	**€8,250,627**	**€8,415,640**
Diferenca Arkëtim/Shpenzime	**€238,990**	**€327,048**	**€419,366**
Investime kapitale vetanake dhe kontigjenca	**€238,990**	**€0**	**€0**
Mbyllja neto	**€0**	**€327,048**	**€419,366**

*tek të tjera janë edhe daljet e parasë jo vetëm si shpenzime por edhe tatimet

Caqet kryesore të performancës

	Të dhënat dhe caqet kryesore të performancës

Kodi dhe treguesi	2026(4muaj parashikim)	2027 plan	2028 projektuar	2029 projektuar
D 001 Uji i prodhuar (m³)	30,800,000	30,000,000	29,500,000	29,500,000
D 002 Konsumatorët e regjistruar (nr.)	70,851	76,374	77,137	77,909
D 005 Uji i faturuar (m³)	8,224,869	10,110,566	10,413,883	10,726,300
D 005.1 Uji i faturuar – amvisëri (m³)	/	8,313,308	8,562,707	8,819,588
D 005.2 Uji i faturuar – joamvisëri (m³)	/	1,692,858	1,743,644	1,795,954
D 005.3 Uji i faturuar – ndërkombëtar (m³)	/	104,400	107,532	110,758
D 006 Faturimi (€)	€7,068,891	€7,965,390	€8,204,351	€8,450,482
D 007 Arkëtimi (€)	€6,783,884	€8,287,840	€8,536,475	€8,792,570
D 008 Të hyrat nga kyçjet dhe të tjera (€)	€21,000	€40,000	€40,000	€40,000
D 009 Shpenzimet operative pa amortizim (€)	€6,280,136	€8,088,850	€8,250,627	€8,415,640
D 010 Investimet vetanake dhe kontigjenc (€)	/	€238,990	€0	€0
D 011 Numri i punëtorëve	349	380	380	380
I 001 Uji i pafaturuar (%)	73%	66.3%	64.7%	63.6%
I 004 Rritja e faturimit (%)	/	19.3%	3.0%	3.0%
I 005 Shkalla e arkëtimit (%)	96%	104.0%	104.0%	104.0%
I 006 Norma e mbulesës së punës	1.08	1.03	1.04	1.05
I 008 Shpenzimet operative për njësi (€/m³)	€0.200	€0.270	€0.280	€0.285
I 009 Efikasiteti i stafit	4.93	4.98	4.93	4.88

7.2. Analiza financiare e shitjes

Analiza e performancës së shitjes për periudhën 2027–2029 paraqet një trend pozitiv të faturimit dhe arkëtimit, të mbështetur në rritjen e bazës së konsumatorëve, rritjen e sasisë së ujit të faturuar dhe integrimin gradual të konsumatorëve të njësive veriore në sistemin individual të faturimit. Numri i konsumatorëve planifikohet të arrijë në 76,374 në vitin 2027, 77,137 në vitin 2028 dhe 77,909 në vitin 2029, ku rritja e konsiderueshme lidhet kryesisht me përfshirjen e konsumatorëve të identifikuar dhe të regjistruar në komunat veriore.

Në aspektin e faturimit total me tvsh, vlera e planifikuar rritet nga rreth 7.07 milionë euro në parashikimin e vitit 2026 në 7.97 milionë euro në vitin 2027, duke arritur në 8.20 milionë euro në vitin 2028 dhe 8.45 milionë euro në vitin 2029. Për vitin 2027 parashihet një rritje prej 19.3%, e ndikuar në masë të konsiderueshme nga zgjerimi i faturimit në njësitë veriore, ndërsa për vitet 2028 dhe 2029 është planifikuar një rritje më e qëndrueshme prej rreth 3% në vit. Paralelisht, sasia e ujit të faturuar planifikohet të rritet nga 10.11 milionë m³ në vitin 2027 në 10.73 milionë m³ në vitin 2029, duke reflektuar zgjerimin e bazës së faturimit dhe përmirësimin gradual të performancës komerciale.

Edhe arkëtimi paraqet trend pozitiv. Për vitin 2027 planifikohen rreth 8.29 milionë euro arkëtime, të cilat rriten në 8.54 milionë euro në vitin 2028 dhe 8.79 milionë euro në vitin 2029. Në nivel të përgjithshëm, plani parasheh një normë arkëtimi prej rreth 104% të faturimit, pasi përveç arkëtimit të faturave të periudhës përfshihet edhe arkëtimi i një pjese të borxheve të akumuluara nga vitet e mëparshme. Për njësitë jugore, ku sistemi i faturimit dhe arkëtimit është i konsoliduar, vazhdon të synohet arkëtimi i faturimit aktual dhe i borxheve të vjetra, ndërsa për njësitë veriore është përdorur një qasje më konservative, duke marrë parasysh se regjistrimi, instalimi i ujëmatësve, faturimi dhe krijimi i disiplinës së pagesave janë ende në proces të konsolidimit.

Në aspektin e efikasitetit operacional, plani parasheh reduktimin gradual të ujit të pafaturuar nga 66.3% në vitin 2027 në 63.6% në vitin 2029, ndërsa norma e mbulesës së punës pritet të përmirësohet nga 1.03 në 1.05. Shpenzimet operative pa amortizim planifikohen të rriten nga 8.09 milionë euro në 8.42 milionë euro gjatë kësaj periudhe, ndërsa numri i punonjësve parashihet të mbetet i pandryshuar në 380. Kjo reflektohet në përmirësimin e treguesit të efikasitetit të stafit nga 4.98 në 4.88 punonjës për 1,000 konsumatorë.

Në tërësi, planifikimi i shitjes për periudhën 2027–2029 synon që rritja e numrit të konsumatorëve të shndërrohet gradualisht në rritje të ujit të faturuar, të hyrave dhe arkëtimit, duke përmirësuar njëkohësisht efikasitetin operacional. Konsolidimi i faturimit individual në veri, arkëtimi i borxheve të vjetra, reduktimi i ujit të pafaturuar dhe kontrolli i shpenzimeve operative paraqesin faktorët kryesorë për realizimin e objektivave financiare të ndërmarrjes.

Plani i faturimit të ujit në m3

Njësia	Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Mitrovicë e Jugut	Shtëpiak	272,072	268,045	256,900	265,452	275,368	271,425	305,435	333,541	314,761	289,982	296,590	252,740	3,402,311
Mitrovicë e Jugut	Joshtëpiak	61,544	60,879	58,105	60,087	62,622	61,628	69,660	76,360	72,164	73,157	73,940	63,682	793,829
Mitrovicë e Jugut	Ndërkombëtar	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	13,200
Vushtrri	Shtëpiak	237,118	233,608	223,895	231,349	239,991	236,554	266,194	290,690	274,322	252,727	258,486	220,270	2,965,204
Vushtrri	Joshtëpiak	48,173	47,652	45,481	47,032	49,017	48,239	54,525	59,769	56,485	57,263	57,876	49,846	621,359
Vushtrri	Ndërkombëtar	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	7,600	91,200
Skenderaj	Shtëpiak	75,552	74,434	71,339	73,714	76,467	75,372	84,817	92,621	87,406	80,526	82,361	70,184	944,793
Skenderaj	Joshtëpiak	12,878	12,739	12,158	12,573	13,104	12,896	14,576	15,978	15,100	15,308	15,472	13,325	166,108
Skenderaj	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Shtëpiak	29,167	35,000	40,833	46,667	52,500	58,333	58,333	58,333	58,333	58,333	58,333	58,333	612,500
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Joshtëpiak	2,917	3,500	4,083	4,667	5,250	5,833	5,833	5,833	5,833	5,833	5,833	5,833	61,250
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zubin Potok	Shtëpiak	11,000	13,200	15,400	17,600	19,800	22,000	22,000	22,000	22,000	22,000	22,000	22,000	231,000
Zubin Potok	Joshtëpiak	833	1,000	1,167	1,333	1,500	1,667	1,667	1,667	1,667	1,667	1,667	1,667	17,500
Zubin Potok	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Leposaviq	Shtëpiak	7,500	9,000	10,500	12,000	13,500	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000	157,500
Leposaviq	Joshtëpiak	1,563	1,875	2,188	2,500	2,813	3,125	3,125	3,125	3,125	3,125	3,125	3,125	32,813
Leposaviq	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ		**769,016**	**769,631**	**750,749**	**783,675**	**820,631**	**820,773**	**909,866**	**983,618**	**934,897**	**883,622**	**899,384**	**784,705**	**10,110,566**

Plani i faturimit në euro

Njësia	Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Mitrovicë e Jugut	Shtëpiak	198,830	195,887	187,742	193,993	201,239	198,357	223,212	243,752	230,027	211,919	216,748	184,702	2,486,409
Mitrovicë e Jugut	Joshtëpiak	65,938	65,226	62,254	64,377	67,094	66,028	74,634	81,812	77,317	78,381	79,220	68,229	850,509
Mitrovicë e Jugut	Ndërkombëtar	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	9,647
Vushtrri	Shtëpiak	173,286	170,721	163,622	169,070	175,385	172,874	194,535	212,436	200,475	184,693	188,902	160,973	2,166,971
Vushtrri	Joshtëpiak	51,612	51,055	48,728	50,391	52,517	51,683	58,419	64,037	60,519	61,351	62,008	53,405	665,724
Vushtrri	Ndërkombëtar	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	66,649
Skenderaj	Shtëpiak	55,213	54,396	52,134	53,870	55,882	55,082	61,984	67,688	63,877	58,848	60,189	51,290	690,454
Skenderaj	Joshtëpiak	13,797	13,648	13,027	13,471	14,039	13,816	15,617	17,119	16,178	16,401	16,577	14,277	177,968
Skenderaj	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Shtëpiak	21,315	25,578	29,841	34,104	38,367	42,630	42,630	42,630	42,630	42,630	42,630	42,630	447,615
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Joshtëpiak	3,125	3,750	4,375	5,000	5,625	6,250	6,250	6,250	6,250	6,250	6,250	6,250	65,623
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zubin Potok	Shtëpiak	8,039	9,647	11,254	12,862	14,470	16,078	16,078	16,078	16,078	16,078	16,078	16,078	168,815
Zubin Potok	Joshtëpiak	893	1,071	1,250	1,429	1,607	1,786	1,786	1,786	1,786	1,786	1,786	1,786	18,750
Zubin Potok	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Leposaviq	Shtëpiak	5,481	6,577	7,673	8,770	9,866	10,962	10,962	10,962	10,962	10,962	10,962	10,962	115,101
Leposaviq	Joshtëpiak	1,674	2,009	2,344	2,679	3,013	3,348	3,348	3,348	3,348	3,348	3,348	3,348	35,155
Leposaviq	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ		**605,562**	**605,923**	**590,603**	**616,372**	**645,462**	**645,252**	**715,811**	**774,255**	**735,803**	**699,004**	**711,055**	**620,288**	**7,965,390**

Plani i inkasimit në euro

Njësia	Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Mitrovicë e Jugut	Shtëpiak	212,748	209,599	200,884	207,572	215,326	212,243	238,836	260,814	246,129	226,753	231,921	197,632	2,660,457
Mitrovicë e Jugut	Joshtëpiak	70,554	69,792	66,612	68,884	71,790	70,650	79,858	87,539	82,729	83,867	84,765	73,005	910,044
Mitrovicë e Jugut	Ndërkombëtar	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	804	9,647
Vushtrri	Shtëpiak	185,416	182,671	175,076	180,905	187,662	184,975	208,152	227,307	214,508	197,622	202,125	172,241	2,318,659
Vushtrri	Joshtëpiak	55,225	54,628	52,139	53,918	56,193	55,301	62,508	68,520	64,755	65,646	66,349	57,144	712,325
Vushtrri	Ndërkombëtar	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	5,554	66,649
Skenderaj	Shtëpiak	59,078	58,204	55,784	57,641	59,794	58,938	66,323	72,426	68,348	62,967	64,402	54,881	738,786
Skenderaj	Joshtëpiak	14,763	14,604	13,938	14,414	15,022	14,784	16,710	18,317	17,311	17,549	17,737	15,276	190,425
Skenderaj	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Shtëpiak	17,052	20,462	23,873	27,283	30,694	34,104	34,104	34,104	34,104	34,104	34,104	34,104	358,092
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Joshtëpiak	2,500	3,000	3,500	4,000	4,500	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	52,499
Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zubin Potok	Shtëpiak	6,431	7,717	9,003	10,290	11,576	12,862	12,862	12,862	12,862	12,862	12,862	12,862	135,052
Zubin Potok	Joshtëpiak	714	857	1,000	1,143	1,286	1,429	1,429	1,429	1,429	1,429	1,429	1,429	15,000
Zubin Potok	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Leposaviq	Shtëpiak	4,385	5,262	6,139	7,016	7,893	8,770	8,770	8,770	8,770	8,770	8,770	8,770	92,081
Leposaviq	Joshtëpiak	1,339	1,607	1,875	2,143	2,411	2,679	2,679	2,679	2,679	2,679	2,679	2,679	28,124
Leposaviq	Ndërkombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ		**636,564**	**634,761**	**616,181**	**641,565**	**670,503**	**668,091**	**743,588**	**806,123**	**764,980**	**725,605**	**738,500**	**641,379**	**8,287,840**

7.3. Burimet e financimit

Burimet e financimit të KRU "Mitrovica" Sh.A. bazohen në një kombinim të qëndrueshëm ndërmjet të ardhurave vetanake dhe fondeve të investimeve kapitale nga donatorët ndërkombëtarë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Komunat dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Të ardhurat vetanake sigurohen kryesisht nga faturimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, i cili përbën bazën kryesore të vetëfinancimit të ndërmarrjes.

Kështu, faturimi dhe inkasimi efikas mbeten burimi themelor për mbulimin e shpenzimeve operative, mirëmbajtjen e rrjetit dhe zhvillimin e projekteve të vogla të kapitalit vetanak. Në anën tjetër, investimet kapitale madhore financohen përmes fondeve të donatorëve ndërkombëtarë si BERZH, KFW, Bashkimi Evropian (IPA) dhe institucione të tjera zhvillimore, si dhe përmes kontributeve të Qeverisë së Kosovës përmes subvencionimit të projekteve kapitale. Këto investime janë të fokusuara në ndërtimin e Impiantit Rajonal të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, investimet në ujëmatesa, valvula, paisje dhe makineri si dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe digjitalizimit të sistemeve operative.

8. PLANI I INVESTIMEVE

Gjatë periudhës 2027–2029, KRU "Mitrovica" Sh.A. do të zbatojë një program të gjerë investimesh që synon përmirësimin e infrastrukturës, modernizimin teknologjik dhe uljen e humbjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ky plan përfaqëson komponentën kryesore zhvillimore të ndërmarrjes dhe është ndërtuar në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në këtë dokument, si dhe me politikat e financimit të miratuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

8.1. Projektet kryesore kapitale

Projektet e investimeve që parashikohen të realizohen në periudhën 2026–2028 janë si më poshtë:

Investimet vetanake

Përshkrimi	Vetanake
Furnizim dhe montim NTU sonda	10,000€
Furnizim me Montim I Softverit per GIS	30,000 €
Investimi në pajisje iPad. Pajisja do të përdoret nga punonjësi për të dokumentuar në mënyrë të menjëhershme dhe të saktë të gjitha aktivitetet operative.	10,000€

Servisimi I elektromoroeve dhe AUMA-ve	20,000€	
Pajisje per matje Gjeodozike "GPS"- Për të tri njesitë: Mitrovice, Skenderaj, Vushtrri.	12,000 €	
Investimet ne IT per njesite operative;Zhvillimi I Sistemit të pagesave offline ne pikat e arketimit;Furnizim me PC desktop dhe Laptop;Zhvillimi I moduleve në ERP dhe Billing etj.	105,000€	
Rehabilitimi i rrugës "Hysni Ferizi", Për rehabilitimin e saj nevojitet shtrirja e rrjetit të ri, per shkak te jofurnizimit te mjaftueshem.	15,000€	
Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Infrastrukturës në Objeket Administrative	36,245 €	
Totali:	**238,245 €**	2027-2029

Projektet e planifikuara

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, BEI, WBIF	Te tjera	Shuma e parashikuar	Periudha e implementimit
1	Mitrovicë- Impianti I trajtimit të ujërave të zeza Mitrovicë-Vushtrri			39,300,000€		39,300,000€	2024-2030
2	Mitrovice , Vushtrri, Skenderaj, Funizimi dhe instalimi i sistemeve të sigurisë në rezervuart e ujit, satcionet e pompave të Kompanisë Rajonale te Ujesjellësit Mitrovica		200,000€			200,000€	2027-2028
3	Mitrovicë - Ngritja e parkut, impianteve Energjetike Fotovoltaike (IEFV)				2,200,000€ KFW(nuk eshte konfirmuar ende)	2,200,000€	2027-2028
4	Mitrovice Skenderaj,Ndertimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ në Suhodoll dhe Skenderaj (Depo dhe Garazha)		270,000€			270,000€	2027-2028
5	Ndertimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ (Depo Garazha, rrethoja dhe mirembajtja e objektit te Drejtorise se Nj.O. - Vushtrri).		130,000€			130,000€	2027-2028
6	Aktiviteti: Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Infrastrukturës në Objeket Administrative (Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri) Ky aktivitet parasheh realizmin e punimeve të mirëmbajtjes dhe përmirësimit në objektet administrative në Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, me fokus në lyerjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, renovimin e banjove (përfshirë ndërrimin e elementeve sanitare dhe pllakave), rregullimin e pllakave në shkallë si dhe ndërhyrje të tjera të	36,245€				36,245 €	2027-2028

	domosdoshme për përmirësimin estetik dhe funksional të hapësirave.				
7	Furnizim dhe montim NTU sonda	10,000 €		10,000 €	2027
8	Furnizim me frekuentor VFD per elektromotor		100,000 €	100,000 €	2027-2028
9	Furnizim me Montim I Softverit per GIS	30,000 €		30,000 €	2027
10	Servisimi I elektromotoreve dhe AUMA-ve	20,000 €		20,000 €	2027-2028
11	Furnizim me Eskavator	100,000€		100,000€	2027
12	Pajisje per matje Gjeodozike "GPS"- Për të operuar ne regjion.	12,000€		12,000€	2027
13	Rehabilitimi I rrugëve: " Gurra", "Shaban Igrishta", 'Demë Ahmeti", ""Tish Daija", "Qazim Cimili','Gjon Sereqi", "Esat Meholli"		50,000€	50,000 €	2027-2028
14	Rehabilitimi I rrugeve ne disa lagje te Mitrovicës: " Ukshin Kovaqica", " Ferki Aliu"		150,000€	150,000€	2027-2028
15	Rehabilitimi I rrjetit te kanalizimit per rrugët: "Ukshin Kovaqica", " Mbretëresha Teutë", " 11 Marsi", "Ferat Dragaj"		315,000€	315,000€	2028-2029
16	Rehabilitimi i rrugës "Hysni Ferizi", e cila ka qene e planifikuar me heret nga KK sipas informative, mirepo shtrirja e gypit eshte bere vetem nje segment dhe pjesa tjeter kane mbetur me gyp te vjeter. Për rehabilitimin e saj nevojitet shtrirja e rrjetit të ri, per shkakte jofurnizimit te mjaftueshem.Gjatësia e Segmentit L=450m	15,000 €		15,000 €	2027
17	Mitrovicë "Ndërrimi dhe montimi i pompave në stacionet e pompimit (Tunel i Pare, Stanterg, Frasher)		125,000€ KIWER	125,000€	2026-2027
18	Mitrovicë-Ndertimi i rezervareve stacionet e pompimit dhe shtrirja e ujësjellësit për disa fshatra të Shalës.		775,000€ KK- ne bashkpunim me KRU	775,000€	2026-2028

19	Vushtrri-Rehabilitimi i ujësjellësit në rrugët: "Kruja", "Arsim Muzaqi" "Naip Rashica", "Fatmir Rashica", "Hamdi Gashi"," Aziz Halili"- Prapa Hotel Kalaja		180,000 €	180,000€	2027-2028
20	Vushtrri-Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për lokacionin ish-stacionin 'Mutfaja' tutje në rrugën 'Dëshmorët e Kombit' deri në rezervuarin pasiv në fshatin Studime Nga puseta kryesore në rr.Ana Lin deri në rr.Shotë Galica		1,800,000€	1,800,000€	2026-2028
21	**Zëvendësimi i gypave të ujësjellësit në rrugën "Halil Kuqi" – Dolak** **Përshkrimi i investimit:** Investimi parasheh zëvendësimin e gypave ekzistues të rrjetit të ujësjellësit në rrugën "Halil Kuqi", në fshatin Dolak, me qëllim përmirësimin e gjendjes teknike të rrjetit dhe reduktimin e humbjeve të ujit. **Arsyetimi i investimit:** Gypat ekzistues të ujësjellësit, të vendosur në këtë segment të rrjetit, janë të një cilësie jo të përshtatshme dhe gjatë funksionimit kanë shkaktuar defekte dhe humbje të konsiderueshme të ujit. Për shkak të gjendjes së tyre teknike, është paraqitur nevoja për zëvendësimin e tyre me gypa të rinj, të përshtatshëm për funksionim të qëndrueshëm dhe afatgjatë.	70,000€		70,000 €	2027
22	Nderrimi i gypave të zinkuar brenda qytetit të Vushtrrisë		285,000	285,000€	2027-2028

23	Ujësjellesi në fshatin „Beçiq dhe Dubovc“ Stacioni Pompimit dhe Trafo Mihaliq Ujësjellesi në fshatin „Gllavotin“ Gypi furnizues në fshatin „Prelluzhë“ Stacioni Pompimit deri në Rezervarin Samadrexhë Ujësjellesi në fshatrat:Sfaraqak, Samadrexhë, Ropic, Maxhunaj, Dumnic e Poshtme, Stanovc i Eperme dhe Gracë “ “Rezervari Samadrexhë” Ujësjellesi nga rezervari ekzistues deri ne rezervarin e ri dhe nga rezervari deri ne Fshatin Sllatinë Ujësjellesi në fshatrat Smerkonicë,Tërllobuq, Sllatinë dhe Gojbul “ dhe “Rezervari Bajskë” Riparimi I Ujësjellesi në fshatrat Arkashticë dhe Balincë Ujësjellesi në rrugën "Bekim Berisha Abeja" Vushtrri		3,200,000€ KK-Vushtrri, ka filluar implementimi I projektit	3,200,000 €	2025-2027
24	Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në rrugët Hoxha dhe Kaqkini &Arsim Sadiku-Klinë e mesme.		30,000€	30,000€	2028
25	Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit për rrugët 28 Nëntori (përfshinë rrugën Ali Gashi), Ahmet Delia,Fehmi & Xhevë Lladrovci.		107,000€ E padefinuar (Mund te jete bashkpunim ne mes KK dhe KRUM)	107,000€	2027
26	Investimet ne IT per te tri njesite operative;Zhvillimi I Sistemit të pagesave offline ne pikat e arketimit;Furnizim me PC desktop dhe Laptop;Zhvillimi I moduleve në ERP dhe Billing etj.	105,000€		105,000€	2027

27	Investimi në pajisje iPad- Për të rritur efikasitetin operacional dhe për të siguruar një proces më të saktë dhe të standardizuar të raportimit në terren, parashikohet investimi në pajisje iPad. Pajisja do të përdoret nga punonjësi për të dokumentuar në mënyrë të menjëhershme dhe të saktë të gjitha aktivitetet operative, duke përfshirë: Fotografimin e pajisjeve, pjesëve të përdorura dhe ndërhyrjeve të realizuara; Regjistrimin e lokacionit gjeografik (GPS) për çdo punë të kryer, duke mundësuar gjurmueshmëri dhe transparencë maksimale; Identifikimin dhe dokumentimin e pajisjeve dhe materialeve të instaluara apo të zëvendësuara; Sinkronizimin e menjëhershëm të të dhënave me bazën qendrore përmes softuerit të dedikuar, duke eliminuar raportimin manual dhe vonesat administrative.	10,000€		10,000€	2027
28	Dy pompa shtytëse dhe rehabilitimi i stacionit në Suhodoll për Zveçan		250,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	250,000 €	2027
29	Funksionalizimi i rezervuarit te ri per Koder te Minatoreve-Mitrovice e Veriut		50,000€	50,000€	2027
30	Zëvendësimi i gypit furnizues DN 200 (2,500 m) Suhodoll-Zvecan		150,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	150,000 €	2027-2028
31	Furnizimi dhe instalimi I 10,000 ujëmatësve për shtëpi dhe biznese		800,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	800,000 €	2027-2028
32	Blerja e një autobote për ujë		100,000 €	100,000 €	2027

33	Blerja e 3 kamionetave operative	150,000 €	150,000 €	2027
34	Blerja e 3 veturave(pickup) operative	100,000 €	100,000 €	2027
35	Blerja e një kamioni për pastrim të kanalizimeve	150,000 €	150,000 €	2027
36	Përfundim I rehabilitimit të fabrikës në Leposaviq	500,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	500,000 €	2027
37	Furnizimi me ujë për ITU-Leposaviq nga puset e Kutnjes	500,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	500,000 €	2026-2027
38	Leposaviq, Belloberd-Modernizimi I procesit te filtrimit dhe rehabilitimi I rez. ekzisutes	KK-Leposaviq 280,000 €	280,000 €	2027
39	Leposaviq-Rehabilitimi I linjes prej 1000m nga AC ne PE	KK-Leposaviq 80,000€	80,000€	2027
40	Lidhjet me gypin kryesor për Zubin Potok, dhe rehabilitimi I gypave ne pjese te ndryshme te Z.P	100,000€	100,000€	2026-2027
41	Turbinë – Hidrocentral në fabrikën në Zubin Potok	200,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	200,000 €	2027
42	Investimi ne ITU-Shipol dhe ITU Balincë: Përmirësimi i SCADA, Dozimit dhe Infrastrukturës Teknike në ITU-Shipol.Ky projekt synon automatizimin e plotë të operimit në ITU-Shipol, përmes aktivizimit të leximit automatik të të dhënave përmes SCADA, eliminimit të ndërhyrjeve manuale. Po ashtu, përfshin rregullimin e dhomave dozuese instalimin e sistemit për dozim automatik të kimikateve dhe funksionalizimin e gjeneratorit te ozonit, me qëllim rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe cilësisë në	300,000€	300,000 €	2027-2028

	prodhimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. 1.) Objekti I klorit: duhet të investohet në funksionalizimin e sistemit automatic të dozimit dhe investime në blerje të bombolave 1,000kg, injektorëve, senzorëve detektues të gazit, gypave transmetues të klorit nga kontejneri deri te injektorët, senzorët për matjen e klorit, filtrate, valvulat etj. 2.) Objekti te filtrate: auma, pajisje të IT-së, sëitch-a. 3.) Objekti te ozone dhe trajtimi I llymit: servisimi i gjeneratorit të ozonit dhe kompersorit të ajrit si dhe investime në kthimin në punë te njësia e trajtimit të llymit. 4.) Objekti i kemikateve: sigurimi i pompave të reja dozuese. 5. Blerja e të gjithë senzorëve (sondave) për matjen e parametrave përmes SKADA-së. 6.)Paisje të IT-së, makinerisë dhe elektros. Stacioni i pompave në Lushtë, sigurimi i xhundave dhe kushinetave, qarqet e pompave, amortizues të gypave, pjesë elektrike, It-së dhe makinerisë.			
43	Laboratori në ITU-Shipol-Paisja e mëtejshme e laboratorit me pajisje dhe inventar shtesë, në mënyrë që të rritet kapaciteti dhe efikasiteti i punës laboratorike, si dhe të përmirësohet siguria dhe saktësia e analizave.Investimi do të përfshijë blerjen e pajisjeve laboratorike shtesë, materialeve harxhuese dhe mobilimit ndihmës, duke kontribuar në përmbushjen më të plotë të kërkesave të	40,000€	40,000 €	2027

	standardeve të cilësisë dhe raportimit. Ky projekt do të ndihmojë në përforcimin e monitorimit të brendshëm dhe në rritjen e besueshmërisë së të dhënave analitike						
44	Elaborati Teknik për Zonat e Furnizuara nga Puset dhe Impiantet Parashihet angazhimi i një operatori të jashtëm për përgatitjen e një elaborati teknik që do të përfshijë analizën e detajuar të zonave të furnizuara nga puset dhe impiantet ekzistuese. Qëllimi i këtij elaborati është të sigurojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për aplikimin dhe marrjen e lejeve ujore për këto zona. Studimi do të përmbajë vlerësimin e kapaciteteve të furnizimit, analizën e kushteve hidroteknike dhe dokumentimin mbështetës në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet relevante, duke kontribuar në rritjen e transparencës, saktësisë dhe përputhshmërisë teknike.				50,000€	50,000€	2027
	Totali:	**238,245€**	**770,000€**	**39,300,000 €**	**13,117,000€**	**53,425,245€**	

8.2. Analiza e fizibilitetit dhe ndikimit

Plani i investimeve përfshin një portofol projektesh me vlerë të përgjithshme të parashikuar prej 53.43 milionë euro, të orientuar në përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, trajtimin e ujërave të ndotura, rritjen e sigurisë së furnizimit, reduktimin e humbjeve, eficiencën energjetike dhe digjitalizimin e proceseve. Struktura e financimit mbështetet kryesisht në burime të jashtme, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare, Qeverinë, komunat dhe partnerë të tjerë, ndërsa pjesëmarrja e mjeteve vetanake të KRU "Mitrovica" është e kufizuar.

Projekti më i madh mbetet Impianti Rajonal i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, me vlerë të parashikuar prej 39.3 milionë euro dhe periudhë implementimi 2024–2030. Projekti paraqet një investim strategjik me ndikim afatgjatë mjedisor dhe operacional, pasi krijon kapacitete për trajtimin e ujërave të ndotura dhe reduktimin e shkarkimeve të patrajtuara në mjedis. Fizibiliteti i tij lidhet kryesisht me përfitimet mjedisore dhe sociale, përmirësimin e standardeve të shërbimit dhe zhvillimin afatgjatë të sistemit të kanalizimit.

Një pjesë e rëndësishme e investimeve është orientuar në rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj dhe njësitë veriore. Projektet për zëvendësimin e gypave të vjetruar, rehabilitimin e segmenteve problematike, ndërtimin dhe funksionalizimin e rezervuarëve, stacioneve të pompimit dhe linjave furnizuese pritet të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së furnizimit, reduktimin e defekteve dhe humbjeve teknike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Në Vushtrri, vetëm grupi i projekteve të ujësjellësit në disa fshatra dhe lokalitete ka vlerë të parashikuar prej 3.2 milionë euro, krahas projekteve të tjera të rehabilitimit të rrjetit.

Investimet në njësitë veriore kanë rëndësi të veçantë për konsolidimin e operimit të KRU "Mitrovica". Projektet përfshijnë rehabilitimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës në Leposaviq, përmirësimin e furnizimit në Zveçan dhe Zubin Potok, zëvendësimin e linjave furnizuese, si dhe furnizimin dhe instalimin e 10,000 ujëmatësve për amvisëri dhe biznese, me vlerë të parashikuar prej 800,000 euro. Këto investime janë të lidhura drejtpërdrejt me procesin e regjistrimit, matjes, faturimit dhe arkëtimit dhe për këtë arsye kanë ndikim teknik dhe financiar në integrimin e plotë të këtyre njësive.

Në aspektin e eficiencës energjetike dhe teknologjike, janë paraparë investime në parkun fotovoltaik, turbinën hidroenergjetike në Zubin Potok, frekuentorë VFD, përmirësimin e SCADA-s dhe automatizimin e proceseve në ITU Shipol dhe Balincë. Këto projekte synojnë reduktimin e konsumit dhe kostove të energjisë, rritjen e kontrollit mbi proceset operative dhe përmirësimin e sigurisë dhe efikasitetit të prodhimit. Projekti fotovoltaik prej 2.2 milionë euro mbetet i kushtëzuar nga sigurimi i financimit, pasi financimi i paraparë nga KfW në tabelë ende figuron si i pakonfirmuar.

Digjitalizimi mbështetet gjithashtu përmes investimeve në ERP, Billing, sistemet e pagesave offline, pajisjet IT, GIS dhe pajisjet mobile për raportimin nga terreni. Këto investime pritet të përmirësojnë kontrollin e proceseve, saktësinë e të dhënave, gjurmueshmërinë e aktiviteteve dhe efikasitetin e raportimit teknik, komercial dhe financiar.

Në përgjithësi, portofoli i projekteve vlerësohet i arsyeshëm nga aspekti teknik, operacional, mjedisor dhe institucional, pasi investimet adresojnë drejtpërdrejt nevojat kryesore të ndërmarrjes: rehabilitimin e infrastrukturës, reduktimin e humbjeve, rritjen e sigurisë së furnizimit, integrimin e njësive veriore, eficiencën energjetike dhe digjitalizimin. Realizueshmëria e një pjese të projekteve mbetet e lidhur me sigurimin në kohë të burimeve të jashtme të financimit, prandaj zbatimi i tyre do të përshtatet me financimin e konfirmuar dhe prioritetet operative të Kompanisë.

8.3. Afatet dhe prioritetet kohore

Plani i investimeve është strukturuar sipas rëndësisë strategjike, nevojave operative, burimeve të financimit dhe gatishmërisë për implementim. Duke qenë se projektet kanë periudha të ndryshme realizimi dhe një pjesë e tyre varen nga financimi i institucioneve të jashtme, prioritetet do të përshtaten me progresin real dhe sigurimin e financimit.

Prioritet të lartë kanë projektet që ndikojnë drejtpërdrejt në vazhdimësinë dhe sigurinë e furnizimit me ujë, reduktimin e humbjeve dhe konsolidimin e operimit në njësitë veriore. Në këtë grup përfshihen rehabilitimi dhe zëvendësimi i rrjeteve të dëmtuara, stacionet e pompimit, rezervuarët, furnizimi me ujë i ITU Leposaviq, rehabilitimi i fabrikës në Leposaviq, linja Suhodoll–Zveçan dhe furnizimi me 10,000 ujëmatës. Shumica e këtyre projekteve janë planifikuar për realizim gjatë viteve 2027–2028.

Prioritet të rëndësishëm përbëjnë edhe projektet e eficiencës energjetike dhe automatizimit, përfshirë parkun fotovoltaik, turbinën hidroenergjetike, VFD-të dhe përmirësimin e SCADA-s dhe sistemeve të dozimit në impiantet e trajtimit. Duke marrë parasysh peshën e energjisë elektrike në strukturën e shpenzimeve operative, këto investime synojnë të zvogëlojnë ekspozimin e Kompanisë ndaj kostove të energjisë dhe të rrisin efikasitetin e proceseve të prodhimit dhe pompimit.

Projekti i Impiantit Rajonal të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, për shkak të vlerës dhe kompleksitetit të tij, shtrihet në periudhën 2024–2030 dhe përbën projektin strategjik afatgjatë të Kompanisë në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbrojtjes së mjedisit. Realizimi i tij zhvillohet paralelisht me projektet e tjera dhe nuk kufizohet vetëm në periudhën trevjeçare të këtij Plani të Biznesit.

Projektet e digjitalizimit, IT-së dhe përmirësimit të kontrollit operacional janë përqendruar kryesisht në vitin 2027 dhe përfshijnë zhvillimin e sistemeve ERP dhe Billing, pagesat offline, pajisjet kompjuterike dhe mobile, GIS-in dhe raportimin digjital nga terreni. Këto investime krijojnë bazën për monitorim më të mirë të performancës dhe integrim të proceseve administrative, financiare, komerciale dhe teknike.

Projektet për sigurinë e objekteve, përmirësimin e objekteve administrative, depove, garazhave dhe infrastrukturës mbështetëse do të realizohen kryesisht gjatë viteve 2027–2028, në përputhje me disponueshmërinë e financimit dhe nevojat operative. Këto projekte kanë rol mbështetës në funksionimin e ndërmarrjes dhe në sigurimin e kushteve të përshtatshme për operim

Në përmbledhje, prioritetizimi i investimeve për periudhën e Planit të Biznesit synon që burimet financiare të orientohen fillimisht drejt projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e furnizimit, reduktimin e humbjeve, funksionalizimin e njësive veriore, eficiencën energjetike dhe përmirësimin e performancës operative. Zbatimi do të monitorohet në vazhdimësi dhe do të harmonizohet me financimin e siguruar, progresin e projekteve dhe nevojat reale të Kompanisë.Në përmbledhje, ndarja në faza e projekteve është bërë në mënyrë që në fillim të periudhës të adresohen kostot më të larta të operimit, si energjia dhe humbjet teknike, ndërsa në fazat pasuese të përqendrohet modernizimi infrastrukturor dhe digjitalizimi. Ky plan siguron që deri në fund të vitit 2029 të rrisë ndjeshëm eficiencën energjetike dhe të zvogëlojë ekspozimin ndaj kostove të energjisë.

9. RREZIQET DHE MENAXHIMI I TYRE

Gjatë periudhës 2027–2029, KRU "Mitrovica" Sh.A. do të operojë në një mjedis me rreziqe financiare, teknike, operative, institucionale, mjedisore dhe të sigurisë, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të Planit të Biznesit. Kompania identifikon, vlerëson, trajton dhe monitoron rreziqet në mënyrë të vazhdueshme, si dhe raporton për gjendjen dhe masat e ndërmarra në nivel të Menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve. Rreziqet kategorizohen sipas mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit, ndërsa për secilin përcaktohen masat e trajtimit dhe bartësit e përgjegjësisë.

Rreziqet financiare

Në aspektin financiar, rreziqet kryesore lidhen me realizimin e faturimit dhe arkëtimit të planifikuar, rritjen e kostove operative, ndryshimet e çmimeve të energjisë elektrike dhe inflacionin. Rrezik i veçantë mbetet ritmi i integrimit komercial të njësive veriore, ku faturimi dhe arkëtimi janë ende në proces të konsolidimit. Raporti i menaxhimit të rreziqeve e klasifikon rrezikun fiskal si rrezik të lartë dhe e lidh atë me mbulimin e kostove, arkëtimin në veri dhe ndikimin tarifor.

Rreziqe shtesë përfshijnë raportimin financiar dhe integrimin e sistemeve, vonesat në realizimin ose financimin e projekteve kapitale dhe rritjen e kostove të furnizimeve dhe shërbimeve. Rreziku ekonomik dhe inflacioni trajtohen gjithashtu si faktorë që mund të ndikojnë si në kostot operative ashtu edhe në aftësinë paguese të konsumatorëve.

Masat parandaluese përfshijnë:

- monitorimin e vazhdueshëm të faturimit, arkëtimit, likuiditetit dhe shpenzimeve;
- forcimin e kontrolleve të brendshme dhe raportimit financiar;
- zhvillimin dhe integrimin e sistemeve ERP dhe Billing;
- kontrollin e kostove dhe përshtatjen e planifikimit financiar sipas zhvillimeve reale.

Rreziqet teknike dhe operative

Infrastruktura e amortizuar, niveli i lartë i ujit të pafaturuar, defektet në rrjet, ndërprerjet e energjisë dhe nevojat për rehabilitim vazhdojnë të përbëjnë ndër rreziqet kryesore teknike të ndërmarrjes. Rreziku i infrastrukturës së amortizuar është vlerësuar si rrezik i lartë, ndërsa masat kryesore lidhen me mirëmbajtjen parandaluese, rehabilitimin e segmenteve kritike dhe prioritizimin e investimeve në zonat me humbje të larta.

Masat parandaluese përfshijnë:

- mirëmbajtjen preventive dhe rehabilitimin e rrjetit;
- reduktimin gradual të ujit të pafaturuar;
- zgjerimin e matjes dhe krijimin e zonave DMA;

- zhvillimin e sistemeve GIS dhe SCADA;
- investimet në pajisje dhe automatizimin e proceseve operative.

Rreziqet institucionale, të sigurisë dhe të teknologjisë

Integrimi i njësive veriore vazhdon të kërkojë koordinim institucional dhe operacional. Rreziku politik dhe i sigurisë në veri është identifikuar si rrezik i lartë, veçanërisht për shkak të ndikimit të mundshëm në arkëtim dhe qasjen në infrastrukturë. Si masa trajtimi parashihen koordinimi me institucionet qendrore dhe lokale, planet alternative operative dhe raportimi periodik.

Njëkohësisht, digjitalizimi në rritje e ekspozon ndërmarrjen ndaj rreziqeve të sistemeve IT dhe sigurisë së informacionit. Për këtë arsye do të vazhdohet me modernizimin e sistemeve, forcimin e sigurisë së të dhënave, kopjet rezervë, trajnimin e stafit dhe investimet në pajisje dhe sisteme të sigurta.

Rreziqet mjedisore

Ndryshimet klimatike, thatësirat, përmbytjet dhe ndotja e burimeve ujore mund të ndikojnë në sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ujë. Rreziku mjedisor dhe ai nga fatkeqësitë natyrore kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ujit, mbrojtjen e burimeve dhe gatishmëri për situata emergjente.

Masat përfshijnë:

- monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së ujit;
- mbrojtjen e burimeve ujore dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse;
- zhvillimin e kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- mirëmbajtjen dhe përditësimin e planeve të reagimit emergjent.

Rreziqet në burimet njerëzore

Zgjerimi i zonës së operimit, rritja e numrit të punonjësve, pensionimet, nevoja për staf profesional dhe integrimi i personelit të njësive veriore paraqesin sfida për menaxhimin e burimeve njerëzore. Raporti ekzistues identifikon si rrezik moshën e stafit dhe kompetencat profesionale, duke paraparë rekrutime sipas nevojës, trajnime dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Masat përfshijnë:

- digjitalizimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- planifikimin e zëvendësimeve për pozitat kritike;
- trajnimin dhe ngritjen profesionale të stafit;
- përshtatjen e numrit dhe strukturës së punonjësve me nevojat reale operative.

Përmbledhje

KRU “Mitrovica” Sh.A. do të vazhdojë të aplikojë një proces të strukturuar të menaxhimit të rrezikut, përmes identifikimit, vlerësimit, trajtimit, monitorimit dhe raportimit të rreziqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të Planit të Biznesit 2027–2029. Për secilin rrezik do të përcaktohen masat e nevojshme dhe përgjegjësitë për trajtimin e tij, ndërsa progresi do të monitorohet dhe raportohet periodikisht. Raporti aktual përcakton rolin mbikëqyrës të Bordit të Drejtorëve dhe përgjegjësinë e Menaxhmentit për zbatimin e masave dhe raportimin.

Në këtë mënyrë, menaxhimi i rreziqeve do të mbetet pjesë integrale e planifikimit dhe vendimmarrjes së ndërmarrjes, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të rreziqeve, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe operacional dhe sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve.

10. PJESA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

KRU “Mitrovica” Sh.A. është shoqëri aksionare me aksione në pronësi të Republikës së Kosovës dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, aktet nënligjore dhe kërkesat rregullative që ndërlidhen me veprimtarinë e ndërmarrjeve publike dhe ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Organizimi dhe funksionimi i KRU “Mitrovica” Sh.A., përfshirë qeverisjen korporative, menaxhimin operacional dhe financiar, planifikimin e investimeve, administrimin e burimeve njerëzore, ofrimin e shërbimeve dhe raportimin institucional e rregullativ, mbështeten në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Ligjin nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat,
- Ligjin nr. 03/L-212 të Punës,
- Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligjin nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Aktet nënligjore dhe aktet e tjera zbatuese që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe që ndërlidhen me veprimtarinë e ndërmarrjes; dhe
- Rregulloret, vendimet, udhëzimet dhe kërkesat rregullative të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), në kuadër të kompetencave të tij ligjore.

Në cilësinë e ofruesit të shërbimeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit, KRU “Mitrovica” Sh.A. është e obliguar të sigurojë ofrimin e shërbimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative, standardet e përcaktuara të shërbimit, kushtet e licencimit, kërkesat për cilësinë dhe sigurinë e ujit, si dhe detyrimet për raportim dhe monitorim të performancës.

Në aspektin e menaxhimit financiar, ndërmarrja zhvillon planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve financiare në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative për ndërmarrjet publike, menaxhimin e financave publike, raportimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve financiare.

Në aspektin operacional, KRU “Mitrovica” Sh.A. planifikon dhe realizon aktivitetet e saj duke marrë parasysh kërkesat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, menaxhimin e burimeve ujore, reduktimin e humbjeve të ujit, sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve, si dhe përmbushjen e standardeve dhe objektivave të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe rregullativ.

Në këtë kuadër, Plani i Biznesit i KRU “Mitrovica” Sh.A. është hartuar duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, detyrimet që burojnë nga licencimi dhe rregullimi i shërbimeve të ujit, objektivat e ndërmarrjes, nevojat për investime në infrastrukturë, kapacitetet operative dhe financiare, si dhe synimet për përmirësimin e qëndrueshëm të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

KRU “Mitrovica” Sh.A. angazhohet që gjatë periudhës së zbatimit të Planit të Biznesit të monitorojë dhe të reflektojë ndryshimet në legjislacionin dhe kuadrin rregullativ në fuqi, duke siguruar përshtatjen e politikave, procedurave, planeve operative dhe financiare të ndërmarrjes me kërkesat ligjore dhe institucionale.

11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Biznesit përbën një proces të vazhdueshëm që synon të sigurojë se objektivat strategjike po realizohen në përputhje me afatet kohore dhe burimet e parashikuara.
KRU "Mitrovica" do të zbatojë një mekanizëm të integruar të raportimit, që përfshin mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave për performancën financiare dhe teknike.

11.1. Mekanizmat e monitorimit

- Raportime mujore dhe tremujore për progresin e aktiviteteve;
- Rishikim i planit të biznesit çdo vit në përputhje me ndryshimet ekonomike e rregullatore;
- Vlerësim i IKP-ve kryesore: prodhimi, faturimi, arkëtimet, humbjet, kostot operative dhe investimet.

11.2. Indikatorët e performancës

Disa nga IKP-të kryesore që do të monitorohen janë:

- Mbulueshmëria me ujë të pijshëm;
- Uji i pafaturuar (% e prodhimit);
- Niveli i arkëtimeve (% e faturimit);
- Raporti i mbulimit të kostove;
- Cilësia e ujit sipas standardeve të analizave laboratorike.

Rezultatet do të raportohen rregullisht tek Bordi i Drejtorëve dhe ARRU, ndërsa gjetjet do të përdoren për përmirësime të brendshme dhe përditësim të planit në bazë të zhvillimeve të reja.

12. MJEDISI, KOMUNITETI DHE TRANSPARENCA

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë ndaj komunitetit, KRU “Mitrovica” Sh.A. do të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi të veçantë mbrojtjes së mjedisit, komunikimit me konsumatorët dhe transparencës institucionale. Këto fusha janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me misionin e ndërmarrjes për ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe me forcimin e besimit të qytetarëve në shërbimet e kompanisë.

Në aspektin mjedisor, prioritet mbetet mbrojtja e burimeve ujore, monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujit, reduktimi gradual i humbjeve dhe përdorimi më efikas i burimeve. Paralelisht, investimet në rehabilitimin e rrjetit, trajtimin e ujërave të ndotura, monitorimin përmes sistemeve moderne dhe projektet e eficiencës energjetike do të kontribuojnë në zvogëlimin e ndikimit të veprimtarisë së ndërmarrjes në mjedis. Rreziku nga ndotja e burimeve dhe ndryshimet klimatike është identifikuar edhe në sistemin e menaxhimit të rreziqeve të kompanisë, ku parashihen monitorimi i cilësisë së ujit, bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse dhe zhvillimi i kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura.

Komunikimi me komunitetin do të zhvillohet përmes informimit të rregullt për shërbimet, investimet, ndërprerjet e planifikuara, cilësinë e ujit dhe çështjet e tjera me interes për konsumatorët. Aktivitetet sensibilizuese do të vazhdojnë të promovojnë ruajtjen dhe përdorimin racional të ujit, përfshirë aktivitetet me rastin e Ditës Botërore të Ujit, bashkëpunimin me institucionet arsimore, komunat dhe organizatat lokale, si dhe fushata të tjera informuese dhe edukative.

Vëmendje e veçantë gjatë periudhës 2027–2029 do t'i kushtohet komunikimit me konsumatorët në njësitë veriore, paralelisht me procesin e regjistrimit, instalimit të ujëmatësve, faturimit dhe inkasimit. Informimi do të zhvillohet në mënyrë të qartë dhe dygjuhëshe, me qëllim që konsumatorët të informohen për shërbimet, tarifat, faturimin, mënyrat e pagesës, procedurat e ankesave dhe të drejtat dhe obligimet e tyre. Kjo qasje synon të mbështesë integrimin gradual dhe krijimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve.

Në aspektin e transparencës, KRU “Mitrovica” do të vazhdojë publikimin dhe komunikimin e informatave relevante mbi aktivitetet, projektet, investimet dhe performancën e ndërmarrjes përmes kanaleve zyrtare të komunikimit. Transparenca do të mbështetet edhe përmes digjitalizimit të proceseve dhe zhvillimit të sistemeve të komunikimit dhe shërbimit ndaj konsumatorëve, duke mundësuar qasje më të lehtë në informata dhe shërbime.

Përmes ndërthurjes së përgjegjësisë mjedisore, angazhimit me komunitetin dhe transparencës institucionale, KRU “Mitrovica” synon të forcojë besimin e publikut dhe të krijojë një marrëdhënie më të afërt me konsumatorët. Qëllimi është që qytetarët të trajtohen jo vetëm si përfitues të shërbimeve, por edhe si partnerë në ruajtjen e ujit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Burimet ujore

Nr	Emri i burimit	x	y	z	Komuna	Kapaciteti (l/s)	Lloji i burimit
1	Liqeni i Ujëmanit	747057 1.489	4755158.735	6 8 9	Zubin Potok	13,500	Akumulues



Figura 4. Burimet ujore